



## **Cikli i dytë i studimeve**

### **“Impakti ekonomik i pandemisë COVID-19: rasti i RMV-së”**

Kandidati:  
Sara Sadiki

Mentor:  
Dr. Shenaj Haxhimustafa

Shtator, 2021

Titulli punues i temës:

**“Impakti ekonomik i pandemisë COVID-19: rasti i RMV-së”**

Përkthimi i titullit punues në maqedonisht:

**“Економското влијание на пандемијата  
КОВИД-19: случај на РСМ”**

Përkthimi i titullit punues në anglisht:

**“Economic impact of the COVID-19: the case of  
RNM”**

## **Falënderime**

Faktor të cilët ndikuan në realizimin e kësaj teme të masterit janë vetëbesimi dhe këmbëngulja dhe se gjithashtu është arritur me përkrahjen pa masë të personave më të afërt të cilët vazhdimisht më kanë përkrahur dhe motivuar të cilëve i jam shumë mirënjohës.

Gjithashtu ky punim nuk do të ishte kryer pa përkrahjen dhe kontributin e pandërprerë të mentorit tim Assoc. Prof. Dr. Shenaj Haxhimustafa , e cila ishte çdo herë në disponim për të më mbështetur që me sukses të punoj tezën e masterit.

Njëkohësisht jam falënderues edhe të gjithë profesorëve tjerë të Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë të cilët u munduan të më mësojnë gjatë studimeve të masterit.

Në mënyrë të veçantë e falënderoj edhe familjen time, në veçanti prindërit të cilët pa inkuarizim tyre nuk do të kisha arritur me sukses të mbroj tezën.

Falënderimi i takon edhe Zotit të lartmadhërishtëm i cili ma mundësoj që me sukses të kaloj të gjitha provimet dhe të arrij qëllimin final që me sukses të mbroj tezën e masterit.

## **PËRMBAJTJA**

|   |  |           |
|---|--|-----------|
| <b>1.1</b>  | <b>Hyrje</b>   | <b>5</b>  |
| <b>1.2</b>  | <b>Qëllimet e studimit</b>   | <b>7</b>  |
| <b>1.3</b>  | <b>Hipotezat e studimit</b>  | <b>7</b>  |
| <b>1.4</b>  | <b>Metodologjia e hulumtimit</b>   | <b>8</b>  |
| <b>1.5</b>  | <b>Rëndësia e punimit</b>  | <b>9</b>  |
| <b>Kapitulli 2</b>  |  | <b>11</b> |
| <b>2.1</b>  | <b>Pasqyra e pandemisë Covid-19 në kontekst global</b>   | <b>11</b> |
| <b>2.2</b>  | <b>Pasqyra e pandemisë Covid-19 në kontekst të RMV-së</b>  | <b>14</b> |
| <b>2.3</b>  | <b>Masat e ndërmarra nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Shëndetësisë për të parandaluar COVID-19</b> | <b>16</b> |
| <b>2.4</b>  | <b>Pasqyra ekonomike e Maqedonisë së Veriut</b>  | <b>20</b> |
| <b>2.4.1</b>  | <b>Konsumi</b>   | <b>20</b> |
| <b>2.4.2</b>  | <b>Prodhimi i brendshëm bruto në RMV</b>   | <b>23</b> |
| <b>2.4.3</b>  | <b>Bilanci buxhetor i qeverisë të RMV</b>  | <b>26</b> |
| <b>2.4.4</b>  | <b>Borxhi publik dhe qeveritar i Maqedonisë Veriore</b>  | <b>28</b> |
| <b>2.4.5</b>  | <b>Tregtia e jashtme e Maqedonisë Veriore</b>  | <b>29</b> |
| <b>Kapitulli 3</b>  |  | <b>31</b> |
| <b>3.1</b>  | <b>Literatura botërore mbi krizën ekonomike pas pandemisë Covid-19</b>   | <b>31</b> |
| <b>3.2</b>  | <b>Literatura e RMV-së mbi krizën ekonomike pas pandemisë Covid-19</b>   | <b>33</b> |
| <b>Kapitulli 4. Metodologjia, rezultatet empirike dhe diskutimi</b> |  | <b>38</b> |
| <b>4.1</b>  | <b>Hyrje</b>   | <b>38</b> |
| <b>4.2</b>  | <b>Modeli i hulumtimit</b>   | <b>38</b> |
| <b>4.3</b>  | <b>Të dhënat</b>   | <b>38</b> |
| <b>4.4</b>  | <b>Metodologjia e hulumtimit</b>   | <b>38</b> |
| <b>4.5</b>  | <b>Specifikimi i modelit</b>   | <b>38</b> |
| <b>4.6</b>  | <b>Modeli linear</b>   | <b>39</b> |
| <b>4.7</b>  | <b>Korelacioni</b>   | <b>40</b> |

|  |    |
|--|----|
| <b>4.8 Testi i regresioni</b>          | 44 |
| <b>4.9 Përfundimi dhe rekomandimet</b> | 46 |
| <b>Referencat</b>                      | 48 |
| <b>Anex A</b>                          | 53 |

## **Kapitulli 1**

### **1.1 Hyrje**

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) për herë të parë shpalli COVID-19 një krizë të shëndetsore botërore në Janar të vitit 2020. Ndërsa më 11 mars të po të njejtin vit, raportoi se në fakt bëhet fjalë për një pandemi, duk e ngriturë atë në nivelin më të lart të urgjencës shëndetsore (Chappell, 2020). Që nga ajo kohë, urgjenca u shndërrua në një shëndetsi të përgjithshme botërore si dhe në krizë monetare e cila ndikoi në ekonominë botërore që arriti në rreth 90 trilionë dollarësh amerikanë për të cilën u nevojit një shekull për të arritur këtë Prodhim të Brendshëm Bruto (PBP). Pasi që në fillim të vitit 2020 së pari filloi të parhapet në Kinë, në fillim të marsit 2020, virusi filloj të zhvendoset nga Kina në Evropë, veçanërisht në Itali, Spanjë, Francë etj., megjithatë nga prilli, gjithashtu filloi të zhvendoset në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku numri i personave të sëmurë filloj të përshpejtohet. Në vitin 2021, edhe ate nga Prilli i këtij viti, shtetet e mëdhaja në zhvillim si India dhe Brazili u shfaqën si zona problematike me numër tepër të lart të sëmundjeve dhe vdekjeve që arritën nivele rekorde çdo ditë.

Përmes periudhave të ndryshme të krizës shëndetsore, çdo qeveri aplikoj strategji të ndryshme për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19 nëpërmjet mbylljes të aktiviteteve shoqërore, kufizimeve të lëvizjes brenda si dhe jasht shtetit. Të gjitha këto politika të aplikuara nga qeveritë ndikoj në uljen drastike të PBP-së që rezultoj në recesion ekonomikë botërorë. Recesioni në disa shtete ishte më i larti që nga lufta e dytë botërore. Pasi që shtetet u përballën me recesione, ishte e nevojshme që të merren masa mbrojtëse me qëllim që të ju ndihmohet kompanive por edhe qytetarëve në aspektin financiar. Për këtë qëllim qeveritë u munduan që të stabilizojnë tregjet financiare si dhe rrjedhjen e kredive duke u munduar që sadopak ti zbusin humbjet e kompanive dhe paketa ekonomike në formë të granteve apo edhe huave me kamata shumë të ulta. Si

ndihmesa tjera që pasuan politikat u orientuan në ato fiskale me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomikë përdërsa qeveritë aprovuan karantina (izolime) dhe distanca shoqërore. Në fazën e tretë, aranzhimet e qeverisë kaluan në krijimin, blerjen dhe shpërndrjen e vakciance kundër pandemisë COVID-19. Derisa kriza ekonomike dhe shëndetsore u përkeqsua edhe më shumë, masat qeveritare ndihmuan sado pak në zbutjen e efekteve negative në shoqëri dhe paralelisht duke ju mundësuar qytetarëve në grupe të ndryshme duke filluar nga mosha më e vjetër dhe ato më të sëmurë të vakcionohen të parët.

Pandemia e COVID-19 u përhap në të gjithë globin, ku sipas Worldometer (2021) numri i të vdekurve ka arritur në 4.3 milion ndërsa janë diagnostifikuar mbi 200 milion qytetar në rruzullin tokësorë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës i prijnë kësaj liste me mbi 36 milion banorë të diagnostifikuar dhe mbi 600 mijë të vdekur. Edhe Maqedonia e Veriut nuk mund që ti shmangej pandemisë duke treguar rritje te rasteve positive me mbi 158 mijë dhe numër të vdekshmërisë mbi 5500 banorë gjë që paraqet edhe vendet me numër më të lart të rasteve në Evropë. Me qëllim të kontrollimit të përhapjes së virusit, më shumë se 80 shtete i mbyllën kufijt e tyre, i detyruan kompanitë gjithashtu të mbyllën, i vendosën popujt e tyre në karantinë si dhe 195 shtete i mbyllën shkollat për 1.5 miliardë fëmijë (O'Hagan, 2020).

Ekonomitë amerikane dhe evropiane përjetuan fillimet e një rimëkëmbjeje ekonomike në tremujorin e tretë të vitit 2020, edhe ate ekonomia amerikane u rrit për 33.4%, ose me një normë vjetore prej 5.0%, duke i mbuluar rëniet e rritjes në tremujorin e dytë. Ekonomia e Eurozonës u rrit me 12.5% gjatë tremujorit të tretë ndërsa norma vjetore e rritjes ekonomike ishte në fakt negative me -7.4%. Megjithatë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, rimëkëmbja u dobësua nga karantinat e reja dhe bllokimet e biznesit në përgjigje të paraqitjes së rasteve infektive dhe shfaqjes së varianteve më ngjitëse të virusit që filloi në shtator të vitit 2020. Produkti real i brendshëm bruto në Shteteve të Bashkuara të Amerikës është vlerësuar të jetë rritur me një normë vjetore të rritjes prej 6.3% gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, ndërsa gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021 ka qeneë 6.5%. Kjo pasqyron që ekonomia rimëkëmbet vazhdimisht, bëhet rihapja e kompanive si dhe ndihmat e qeverisë qofshin ato në formë të huave apo granteve janë

rritur dhe kanë qenë efektive (Bureau of Economic Analysis, 2021). Kongresi Amerikan miratoi një stimul ekonomik në vlerë prej 1.9 trilionë dollarësh, të caktuar si Akti Amerikan i Planit të Shpëtimit (P.L. 117-2), që u nënshkrua nga Presidenti Biden më 11 Mars 2021 (Congressional Research Service, 2021). Gjithashtu edhe shtetet tjera të zhvilluara paten stimulime ekonomike, duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, në të cilën kancelari i Thesarit më 3 Mars 2021 njoftoi një stimul prej 65 miliardë £ paketë për dy vjet për të ringjallur ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar që përbëhet nga stimujt për biznese të ndryshme dhe masat mbështetëse për të ardhurat e punëtorëve që do të pasohen nga rritja e taksave duke filluar në 2023 (Pickard et al., 2021).

Stimulime ekonomike paten shumë shtete në botë duke përfshirë edhe shtetet ballkanike në këtë rast edhe në Maqedoninë e Veriut. Masat ekonomike të dizajnuara nga konsultimet të gjëra dhe debate të shumta, në total në Maqedoninë e Veriut janë sjellur 6 paketa të masave ekonomike duke filluar nga periudha mars dhe prill 2020 deri në periudhën prill 2021. Këto paketa ekonomike kishin për qëllim të ju jepen kompanive që cilat hasën vështirësi në veprimtari që nga fillimi i pandemisë COVID-19 si dhe qytetarëve që sado pak do tua lehtësoj vështirësitë financiare gjatë kësaj periudhe kohore (Qeveria e RMV, 2021).

Duke marrë parasysh ndikimin e madh që paraqiti pandemia COVID-19 në ekonominë e RMV unë e kam zgjedhur këtë temë për të studiuar sepse aktualisht shumë pak studime janë bërë në këtë lëmi dhe se është një temë mjaft aktuale jo vetëm në RMV mirpo edhe në nivel global. Kjo nënkupton që fokusi i hulumtimit në këtë studim është të eksploroj dhe të studioj ndikimin e pandemisë COVID-19 në ekonominë e RMV-së. Për këtë qëllim është studiuar kriza ekonomike e paraqitur nga COVID-19 në RMV, rëndësia e masave politike monetare dhe fiskale të ndërmarra nga RMV, menaxhimi i infrastrukturës së shëndetit publik si dhe programet e mirëqenies sociale në RMV në zbutjen e krizës ekonomike.

## **1.2 Qëllimet e studimit**

Në këtë punim studiohet ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e RMV-së, duke u bazuar në atë që edhe RMV nuk mund ti shmangej pandemisë dhe se pasojat ekonomike ishin të

paevitueshme. Duke filluar nga ky princip disa nga qëllimet që do të mundohemi ti arrijmë në këtë studijm përfshijnë:

- Çfarë ndikimi ka patur pandemia COVID-19 në ekonominë e RMV-së.
- Cilat janë masat ekonomike të ndërmarra nga ana e qeverisë së RMV-së në zbutjen e krizës ekonomike në vend.
- Sa kanë qenë efektive masat ekonomike të qeverisë së RMV-së në ringjalljen ekonomike të vendit.

### **1.3 Hipotezat e studimit**

Në mënyrë që arrihen qëllimet e punimit do të investigohen këto hipoteza:

- H1/1: Nuk egziston lidhje e rëndësishme midis konsumit dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H1/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis konsumit dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H2/1: Nuk egziston lidhje e rëndësishme midis shpenzimeve qeveritare të ndërmarra nga qeveria dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H2/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis shpenzimeve qeveritare të ndërmarra nga qeveria dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H3/1: Nuk egziston lidhje e rëndësishme midis borxhit të përgjithshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H3/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis borxhit të përgjithshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H4/1: Nuk egziston lidhje e rëndësishme midis tregtisë së jashtme dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19
- H4/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis tregtisë së jashtme dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19



Pasi që të gjitha krizat ekonomike në çdo shtet kanë burimet e tyre në këtë rast pritet që të vërtetohet nëse ka patur ndonjë lidhshmëri në mes krizës ekonomike në RMV dhe COVID-19 që e kemi paraqitur si Hipotezë të parë. Çdo shtet është munduar që në format e tyre të veçanta të zbutë pasojat që vijnë nga pandemia e COVID-19 duke u munduar me masa politike monetare por edhe fiskale të zvoglojnë krizën ekonomike, neve na intereson pra se çfarë ndërlishmërie kanë këto në RMV. Duke marrë parasysh sistemin shëndetsor të RMV-së dhe shokun që e kaploi nga pandemia parashtrohet pyetja se është ndër shkaktarët e krizës ekonomike në RMV. Si hipotezë të katërt kemi paraqitur mirëqenien sociale të RMV-së dhe zvoglimit të krizës ekonomike si programe të veçanta të ndërmara nga qeveria e RMV-së.

#### **1.4 Metodologjia e hulumtimit**

Gjatë këtij studimi do të përdoren metoda të avancuara shkencore dhe hulumtuese të shoqëruara nga përkufizime nga literatura akademike e autorëve vendor dhe ndërkombëtar. Literatura për këte temë është ende në zhvillim e sipër.

Gjatë këtij studimi do të analizohen hulumtime, punime, libra të ndryshëm, që flasin për këtë temë dhe do të ndërlidhen me këtë punim. Do të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë, dhe hulumtimet e ndryshme në lidhje me impaktin ekonomik të pandemisë COVID-19 në RMV. Në mënyrë që të vërtetohet validiteti i hipotezave, hulumtimi bazohet në të dhëna të publikuara nga institucione relevante qeveritare të RMV-së si dhe ndërkombëtare, edhe ato nga Ministria e Financave, Ekonomisë, Shëndetsisë, Banka Popullore e RMV-së, Enti Statistikorë i RMV-së, Banka Botërore, Fondi Monetarë Ndërkombëtar, UNCTAD, etj. Të dhënat që kryesisht do të bazohemi do të jenë nga Enti Statistikorë i RMV-së duke përfshirë raportet e publikuara si dhe databazën elektronike të tyre.

Të dhënat kryesisht do të analizohen sipas metodës kuantitative deskriptive, mirpo gjithashtu do të zbatohen edhe metoda bashkëkohore për të studiuar variablat e paraqitura me qëllim që të arrihen objektivat e hulumtimit dhe të vërtetohen hipotezat e parashtruara.

Si pjesë aplikative do të përdoret softveri statistikor SPSS në mënyrë që të arrihet në output të të dhënave dhe analizohen të dhënat e grumbulluara me metoda të ndryshme statistike, sipas edhe të cilës do të vertetohen hipotezat e parashtruara në këtë hulumtim.

Para se të dhënat të analizohen në formë regresioni, do të kryhet një test statistikor përshkrues për të siguruar një pamje të përgjithshme të shpërndarjes dhe sjelljes së ndryshoreve në përdorim. Kjo përfshin shfaqjen e tendencave të variablave në formën e tabelave, grafikëve dhe çarteve. Testi për normalitetin e serive të të dhënave do të zhvillohet dhe p-vlera e tij do të vëzhgohen për signifikanca (domethënie).

### **1.5 Rëndësia e punimit**

Zbulimet e këtij punimi hulumtues do të luajnë një rol thelbësor në sektorët vijues:

Informacioni dhe gjetjet e këtij studimi do të jenë të dobishme për studentët e UEJL. Rezultatet e marra nga ky studim mund të përdoren si një studim i rastit nga studentët në Universitetet brenda RMV-së ose në mbarë botën.

Qeveria. Gjetjet e studimit mund të përdoren nga çdo autoritet rregullator qeveritar i cili mund të gjejë rekomandimet nga studimi të cilat kanë për qëllim përmirësimin e krizës ekonomike në RMV.

Studiuesit. Studimi formon një shtesë të vlefshme për rishikimet e letërsisë dhe studiuesit që janë të përfshirë në një bollëk fushash të tilla si menaxhimi i kredisë, biznesi, financa, çështjet makroekonomike, kriza ekonomike, etj. Kështu, ata mund të përdorin këtë studim për të çuar më tej njohuritë e tyre.

Studimi do të jetë i dobishëm për popullatën e përgjithshme që jeton në RMV ose më gjerë, përmes së cilës hulumtimi do të sjellë identifikimin e situatës makroekonomike në RMV gjatë krizës ekonomike me përhapjen e pandemisë Covid-19 dhe pas saj.

Në fund të fundit, ky studim kërkimor mund të jetë një udhëzues i mirë për të hulumtuar më tej çështjet dhe për të studiuar më thellë variablat makroekonomike që mund të kenë zbutur krizën ekonomike me paraqitjen e pandemisë Covid-19.

Për më tepër, për të gjithë këta përfitues, hulumtimi mund të jetë një referencë e mirë për organizatat e qeverisë së RMV, të tilla si nivelet e ministrisë, si dhe për organizatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me këtë lloj çështje.

## **Kapitulli 2**

### **2.1 Pasqyra e pandemisë Covid-19 në kontekst global**

Është diçka e jashtëzakonshme që një sëmundje e re të bëhet një pandemi e vërtetë. Që nga shfaqja e saj në Wuhan, Kinë, në fund të vitit 2019, sindromi i rëndë akut respirator koronavirus 2 (SARS-CoV-2), virusi që shkakton COVID-19, është përhapur në pothuajse të gjitha vendet e botës në vetëm disa muaj. Sidoqoftë, në vende të ndryshme, epidemia e COVID-19 merr forma të ndryshueshme në mënyrën se si ndikon në shoqëri. Deri më tani, njohuritë e fituara mbi COVID-19 janë dominuar kryesisht nga epidemitë e COVID-19 dhe lockdown-at në Kinë, Evropë dhe SHBA. Por kjo shumëllojshmëri e trajektoreve globale është pak e përshkruar, analizuar apo kuptuar. Vetëm në pak muaj, një sasi e madhe e provave shkencore mbi SARS-CoV-2 dhe COVID-19 janë zbuluar. Por boshllëqet e rëndësishme të njohurive mbeten të panjohura. Mësimi nga shumëllojshmëria e mënyrave se si po përhapet epidemia COVID-19 në

të gjithë globin mund të kontribuojë potencialisht në zgjidhjen e enigmës COVID-19 (Damme, et al., 2020).

COVID-19 është përhapur në të gjithë botën përmes udhëtarëve ndërkombëtarë. Koha e futjes së COVID-19 në masë të madhe varet nga intensiteti i lidhjeve me vendet me epidemitë e vazhdueshme të COVID-19. Kështu që ajo arriti së pari në qendrat e mëdha urbane dhe, brenda këtyre, shpesh grupet më të pasura. Nga atje, virusi është përhapur me shpejtësi të ndryshueshme në grupet e tjera të popullsisë në botë (Eyawo, 2020).

Epidemia COVID-19 është përhapur më ngadalë dhe më pak intensivisht në zonat rurale, në Afrikë dhe nënkontinentin Indian, dhe zonat rurale të vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Jo vetëm media, por edhe bashkësia shkencore i ka kushtuar shumë më pak vëmendje këtyre realiteteve, duke u shfaqur më vonë dhe duke u përhapur më ngadalë. Mendimi dominues ka qenë se është vetëm një çështje kohe para se epidemia të përhapet kudo (CDDEP, 2020).

Rasti i parë COVID-19 jashtë Kinës u raportua në Tajlandë më 13 janar 2020, 2 ditë pasi Kina raportoi vdekjen e saj të parë më 11 janar 2020 (OBSH, 2020). Ky rast çoi në procese më të rrepta të shqyrtimit për udhëtarët me ethe apo simptoma tjera të ngjashme të gripit në aeroportet në Tajlandë, Hong Kong, Korenë e Jugut dhe Singapor (Secon et al., 2020). Më 20 janar 2020, rasti i parë u raportua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te një person që ishte kthyer nga Wuhan, Kinë (Secon et al., 2020). SHBA shpalli COVID-19 si një Urgjencë të Shëndetit Publik më 31 Janar 2020, një ditë pasi OBSH shpalli përhapjen si një Emergjencë Globale të Shëndetit Publik (Secon et al., 2020, OBSH, 2020, Worldometer, 2021).

Më 31 janar 2020, rastet e para u raportuan në Suedi dhe Spanjë, si dhe dy rastet e tyre të para u raportuan në Rusi dhe Mbretëri të Bashkuar (Worldometer, 2021, Departamenti i Shëndetit dhe Kujdesit Social, 2020 & Sofiychuk, 2020). Në kohën që e shkruajm këtë tezë të masterit, SARS-CoV-2 po vazhdon të përhapet globalisht. Tabela 1 tregon 10 vendet kryesore me numrin më të lartë të rasteve të COVID-19 të raportuara në 16 Dhjetor 2021 (Worldometer, 2021). Shumë faqe në internet paraqesin përditësimet më të fundit mbi numrin e rasteve të COVID-19 në të gjithë botën. Edhe pse SHBA nuk ishte vendi i parë në botë në të cilën u paraqit COVID-19 ajo deri në ditën e raportimit të të dhënave kryeson me numrin më të lartë të rasteve me virusin

COVID-19 duke u ndjekur nga shtetet e mëdha si India, Brazili, Mbretëria e Bashkuar, Rusia etj. Është me rëndësi të theksohet se Kina si shtet në të cilën u paraqitën rastet e para të COVID-19 që njëherit njihet edhe si burim i virusit, e ka kontrolluar në mënyrë shumë të suksesshme përhapjen e saj dhe tani renditet shumë posht në tabelë të llogaritur nga Worldometer (2021) edhe ate në vendin e 113 nga gjithsejt 224 vende të analizuara.

Tabela 1. 10 vendet kryesore me numrin më të lartë të rasteve të COVID-19 më 16 Dhjetor 2021 (Worldometer, 2021).

| Nr. | Shtetet              | Gjithsej Rastet | Gjithsej Vdekjet | Gjithsej të shëruar | Gjithsej rastet/1M pop | Vdekjet/1M pop |
|-----|----------------------|-----------------|------------------|---------------------|------------------------|----------------|
| 1   | SHBA                 | 51,435,652      | 824,520          | 40,406,796          | 154,078                | 2,470          |
| 2   | Indi                 | 34,726,049      | 476,869          | 34,154,879          | 24,809                 | 341            |
| 3   | Brazil               | 22,204,941      | 617,521          | 21,414,318          | 103,395                | 2,875          |
| 4   | Mbretëria e Bashkuar | 11,097,851      | 146,937          | 9,658,375           | 162,237                | 2,148          |
| 5   | Rusi                 | 10,131,646      | 294,024          | 8,876,788           | 69,383                 | 2,014          |
| 6   | Turqi                | 9,118,424       | 79,863           | 8,712,929           | 106,449                | 932            |
| 7   | Francë               | 8,460,712       | 121,171          | 7,430,199           | 129,203                | 1,850          |
| 8   | Gjermania            | 6,709,218       | 108,154          | 5,618,600           | 79,706                 | 1,285          |
| 9   | Iran                 | 6,165,454       | 130,946          | 5,990,898           | 72,062                 | 1,531          |
| 10  | Spanja               | 5,422,168       | 88,667           | 4,965,069           | 115,905                | 1,895          |
| 113 | Kinë                 | 100,000         | 4,636            | 93,858              | 69                     | 3              |


Burimi: Worldometer (2021). Reported Cases and Deaths by Country or Territory

Sipas të dhënave të Worldometer (2021) mbi 100 shtete e kanë tejkaluar Kinën sipas numrit të rasteve të infektuar me virusin COVID-19, vendi në të cilin filloi shpërthimi i virusit. Shumë faktorë kanë ndikuar në rritjen e numrit të rasteve, të tilla si madhësia dhe popullsia e vendeve përkatëse. Nuk do të ishte e përshtatshme të gjykohehin aftësitë e autoriteteve në trajtimin e rasteve të sëmundjeve bazuar në numrin e vdekjeve totale dhe rasteve të shëruara totale, pasi që grupet e rasteve të infektuara janë të ndryshme në secilin vend. Në fakt ato grupe njerëzish me një sistem imunitar të komprometuar, të moshuarit dhe individët me sëmundje të tjera janë më të ndjeshëm ndaj COVID-19, duke përfshirë edhe vdekjen (Lu et al., 2020, Carlos et al., 2020, Xia et al., 2020). Një mjedis i ftohtë është një faktor tjetër që mund ta bëjë këtë virus vdekjeprurës të mbijetojë më gjatë dhe të përhapet në mënyrë aktive dhe më të shpejtë. Prandaj, vendet me një

popullsi më të lartë të të moshuarve dhe ato me klimë të ftohtë kanë raportuar një numër më të lartë të vdekjeve dhe një numër më të ulët të të shëruarve.

Numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara me virusin COVID-19 në nivel global në kohën kur të dhënat u morën për Tabelën 1, pra më datë 16 Dhjetor 2021 (Worldometer, 2021) ishte 273,210,499, me 5,352,847 vdekje, 245,292,964 të shëruar, 35,050 gjithsej rastet në 1 milion banorë si dhe 686.7 vdekje në 1 milion banorë. Në figurën 1 janë përmbledhur të dhënat për numrin e përgjithshëm të rasteve aktive, vdekjeve, të shëruarve, gjithsej rasteve në 1 milion banorë si dhe vdekjeve në 1 milion banorë në të gjithë botën.

Figura 1. Të dhënat e ndara për COVID-19 në nivel global, deri më 16 Dhjetor 2021




## 2.2 Pasqyra e pandemisë Covid-19 në kontekst të RMV-së

Pas fillimit të përhapjes së COVID-19 në Evropë nga Kina, filluan të regjistrohen edhe rastet e para në Maqedoninë e Veriut. Rasti i parë pozitiv me COVID-19 që mund të quhet edhe si zero pacienti është raportuar më datë 26 Shkurt të vitit 2020 (Mitev & Drangovska, 2021). Që nga ajo kohë rastet aktive në Maqedoninë e Veriut vazhdimisht janë rritur. Me paraqitjen e rasteve të para u ndërmorrën edhe masa të konsiderueshme nga ana e qeverisë, gjegjësisht nga autoritetet shëndetsore duke aplikuar edhe masa drastike me qëllim të kontrollimit të përhapjes së virusit me aplikime të lockdown, ose izolime totale të disa qyteteve në fillimi mirpo edhe të shtetit më vonë.

Gjithashtu u aplikuan edhe masa drastike si orë policore për periudha të ndryshme kohore si dhe situata të gjendjes së jashtzakonshme të vendosura nga vet Presidenti Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto masa të ndërmarra ndikuan që në fillim të ndalohet përhapja e virusit në nivel të shtetit dhe të izolohet në lokacionet e paraqitura.

Maqedonia e Veriut deri më tani, është përballur me katër vale të pandemisë COVID-19 (shiqo figurën 2). Vala e parë e rasteve aktive është mesi i korrikut 2020, pas së cilës fillon të ulet numri me raste aktive të COVID-19. Vala e dytë e rasteve aktive është mesi i dhjetorit 2020, pas së cilës, numri i rasteve aktive me COVID-19 ka qenë në rënie të vazhdueshme (OECD 2021). Vala e tretë e rasteve aktive u paraqit ka mesi i prillit 2021. Më 8 Prill 2021, Maqedonia e Veriut kishte 22.164 raste aktive dhe 138.891 raste në total. Duke u ulur në mënyrë të vazhdueshme, situata arriti të përmirësohet dukshëm, gjë që më 5 Korrik 2021, numri i rasteve aktive u ul në minimum 130 raste aktive. Vala e katërt e rasteve aktive e pandemisë në Maqedoninë e Veriut paraqitet në fund të muajit Gusht 2021, ku deri më datë 17 Dhjetor 2021 kishte 5437 gjithsej raste aktive (IPH, 2021 & Worldometer, 2021).

Figura 2. Evolucioni i rasteve aktive me COVID-19 në Maqedoninë e Veriut deri më 17 Dhjetor 2021




Burimi: IPH, (2021) & Worldometer, (2021), Active Cases in North Macedonia

Në figurën 3 janë përmbledhur të dhënat për numrin e përgjithshëm të rasteve aktive, vdekjeve, të shëruarve, gjithsej rasteve në 1 milion banorë si dhe vdekjeve në 1 milion banorë në Maqedoninë e Veriut. Sipas të dhënave të fundit të Worldometer deri më 17 Dhjetor 2021 në Maqedoninë e Veriut kishte 220,794 gjithsej raste, 7,794 gjithsej vdekje, 207,563 gjithsej të shëruar, 5,437 gjithsej raste aktive, 105,985 gjithsej raste në 1 milion banorë si dhe 3,741 gjithsej vdekje në 1 milion banorë (Worldometer, 2021).

Figura 3. Të dhënat e ndara për COVID-19 në Maqedoninë e Veriut, deri më 17 Dhjetor 2021





### 2.3 Masat e ndërmarra nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Shëndetësisë për të parandaluar COVID-19

Paraqitja e pandemisë COVID-19 në Kinë nuk u morë seriozisht në fillim nga qytetarët e Maqedonisë së Veriut në aspektin se sa vdekprurës mund të jetë ai. Qytetarët gjithashtu nuk ishin të përgatitur mirë për të luftuar pandeminë, kryesisht për shkak se për herë të parë përhapet një pandemi në shtet dhe gjithashtu sepse u siguruan që virusi nuk do të përhapet lehtë në Maqedoninë e Veriut. Sidoqoftë, me numrin e rasteve pozitive të COVID-19 në Maqedoninë e Veriut duke u rritur gradualisht filloi të përhapet edhe panika në shoqëri (Worldometer, 2021). Si pasojë, qeveria ndërmori shumë hapa për të lehtësuar panikun masiv dhe për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve.

Qeveria, gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë së RMV-së luajti një rol vendimtar në sigurimin e gatishmërisë maksimale për të kontrolluar përhapjen e virusit. Ndër përpjekjet më të hershme të ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë për të parandaluar transmetimin e sëmundjeve ishte zbatimi i mbajtjes së maskave si dhe mjeteve tjera mbrojtëse. Këto masa filluan të ndërmerren që

në fillim të pandemisë me mbajtjen e mbledhjes së pare të qeverisë për parandalimin e përhapjes së COVID-19 më datë 25 Shkurt, 2020 (Qeveria e RMV, 2020). Në mënyrë të vazhdueshme në çdo mbledhje tjera të rradhës janë diskutuar masa të ndryshme për parandalim të COVID-19 në RMV. Masa tjera shtesë për parandalimin e shpërndarjes së padëshirueshme të korona virusit ishte anulimi i të gjitha tubimeve publike në mars të vitit 2020. Qeveria në mars të vitit 2020 (Qeveria e RMV, 2020) poashtu vendosi që:

- aktivitetet sportive të mbahen pa publikë;
- ndalesë e udhëtimeve në vende me rrezik të lart të koronavirusit si dhe ardhja e turistëve nga vende me rrezik të mesëm dhe të lartë;
- lirimin e personave nga puna që kanë sëmundje kronike të ndryshme;
- shkurtim i orarit të punës;
- izolim in një pjese të territorit të RMV-së si psh të Dibrës dhe Qendër Zhupa për shkak të përhapjes së virusit në ato rajone;
- mbyllja e qendrës së skijimit në Mavrovë, mbyllja e qendrave tregtare, kafeterive, bastoreve sportive, kazinove;
- mbyllja e aeroportit të Ohrid dhe Shkupit;
- sjellja e e gjendjes së jashtzakonshme në RMV;
- masa ekonomike për mbështetje financiare të likuiditetit të kompanive mikro, të vogla dhe të mesme nga ane e Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut për marrje të kredive. Secila kompani, varësisht nga numri i të punësuarve, do të mund të merr nga 3 deri në 30 mijë euro, Mikro kompanitë, deri në 10 të punësuar, do të mund të marrin kredi prej 3 deri në 5 mijë euro, kompanitë e vogla me 10 deri në 50 të punësuar, do të mund të marrin kredi prej 10 deri në 15 mijë euro dhe kompanitë e mesme me 50 deri në 250 të punësuar, do të mund të marrin kredi prej 15 deri në 30 mijë euro. Kreditë janë pa interes, me një normë interesi prej 0 përqind me një periudhë mospagimi prej 6 muaj dhe një periudhë shlyerjeje prej 2 vite;
- Masa e dytë ka të bëjë me mbështetjen e kompanive në pjesën e pagesës së pagave me subvencionim të kontributeve për të punësuarit në kompani në sektoret e turizmit, transportit, hotelierike dhe kompani të tjera të prekura, për muajt prill, maj dhe qershor të

vitit 2020, me subvencion të kontributeve në të punësuar në lartësi prej 50 % nga paga mesatare e paguar në vitin 2019, me kusht që kompania të mos e zvogëlojë numrin e të punësuarve nën numrin e të punësuarve në muajin shkurt të vitit 2020 dhe kjo të vlejë deri në ditën e shfrytëzimit të masës;

- Të ndalohet lëvizja e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën kohore nga 21:00 -06:00, për qëllim të shpërndarjes të sëmundjes infektive COVID-19 dhe mbrojtjen e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për periudha të ndryshme kohore të lëvizjes mvarsisht prej moshës dhe ditëve të javës;
- vendosjen e platformës Nacionale për e-mësim, etj.

Qeveria në mënyrë të vazhdueshme në mbajtjet e mbledhjeve të rradhës ka ndërmarrë masa tjera shtesë të rëndësishme për parandalim të përhapjes së COVID-19 (Qeveria e RMV, 2020), edhe ate ndër më të rëndësishmet janë miratimi i pesë pako masash ekonomike për të ruajtur likuiditetin e kompanive dhe vendeve të punës. Masat ekonomike janë hartuar pas një konsultimi të gjerë dhe një debati thelbësor me anëtarët e Këshillit Ekonomik, të formuar për këtë qëllim, si dhe përmes bisedave që qeveria ka pasur me komunitetin e biznesit përmes dhomave të tregtisë, dhe përmes bisedave të veçanta me ekspertët ekonomikë nga akademia dhe sipërmarrës me reputacion dhe të suksesshëm të sektorit real.

Që nga shfaqja e koronavirusit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore ka miratuar 4 pako masash, që kanë për qëllim përbalimin e pasojave negative në ekonomi. Brenda këtyre pakove, janë miratuar rreth 70 masa të ndryshme, të cilat mbulojnë dhe mbështesin entitetet dhe individët e prekur nga pandemia.

Të gjitha paketat e masave kundër krizës për të mbështetur ekonominë fokusohen tek qytetarët, punët e tyre, sigurimet shoqërore, solidariteti, krijimin e një mjedisi për kapërcimin më të lehtë të pasojave ekonomike të koronavirusit dhe zbatimin e një strategjie të shpejtë të daljes kur kriza të ketë mbaruar për të vazhduar me trendet pozitive të zhvillimit të ri të ekonomisë së Maqedonisë.

Krijimi i masave për të gjitha paketat u bë në mënyrë transparente dhe në një proces gjithëpërfshirës në të cilën morën pjesë dhomat e tregtisë, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve për të mbuluar numrin maksimal të qytetarëve të prekur nga kriza.

Vlera e të katër pakove të masave kundër krizës është rreth 1 miliard e 20 milionë euro, pra pakoja e katërt e masave ekonomike është 470 milionë euro, ndërsa vlera e përgjithshme e tri pakove të mëparshme është rreth 555 milionë euro. Këto mjete financiare u drejtohen qytetarëve dhe ekonomisë për të siguruar qëndrueshmërinë e ekonomisë me potencial për rigjallërim. Pakoja e pestë ekonomike përfshinte përafërsisht rreth 160 milion euro.

Deri në shkurt 2021, 704 milion euro u shpenzuan plotësisht për trajtimin e efekteve të koronavirusit, pra 67.3% të mjeteve të alokuara në këto 4 pako. Rreth 156 milionë euro janë mjete të papërdorura, kështu që shuma e përgjithshme e mjeteve të zbatuara është 860 milionë euro ose 82% e planit të përgjithshëm të mjeteve për masat. Nëse marrim parasysh se masa për linjën e kredisë nga Banka Evropiane për Investime është në procedurën përfundimtare, përqindja e zbatimit të masave do të rritet në 92%. Shumica e masave nga pakoja e tretë dhe veçanërisht nga e katërta janë planifikuar të zbatohen gjatë gjithë vitit 2021 dhe madje edhe më gjatë. Prandaj, duhet të kihet parasysh se një pjesë e masave brenda paketës së tretë janë planifikuar dhe zbatuar si pjesë e paketës së katërt të masave.

Nga gjithsej 70 masa të miratuara brenda 4 pakove, 35 janë zbatuar në vlerë prej 704 milionë euro, zbatimi i 21 masave në vlerë prej 30 milionë euro është në vazhdim, ndërsa zbatimi i 7 masave në vlerë prej 150 milionë euro janë në pritje në procedurën e Parlamentit ndërsa 7 masa me vlerë 8.7 milionë euro nuk janë zbatuar, gjithashtu 5 masa kanë një shkallë më të lartë të realizimit sesa mjetet e planifikuara në vlerë prej 2.1 milion euro.

Të gjitha masat e miratuara mund të ndahen në një nga 3 grupet e mëposhtme:

- Masa që shkaktojnë shpenzime buxhetore ose implikime të drejtpërdrejta fiskale,
- Masa që shkaktojnë reduktim të të ardhurave buxhetore, dhe
- Masa që kanë ndikim ekonomik dhe nuk kanë implikime fiskale.

Masat ekonomike dhe sociale janë renditur më poshtë, që në total janë 106, për parandalimin e krizës të COVID-19 që nga fillimi i miratimit të paketës së parë të masave ekonomike nga marsi dhe prilli 2020, deri në shtesën e fundit në paketën e gjashtë të masave ekonomike në vlerë prej 17.8 milion euro për të mbështetur aktivitetet që ishin mbyllur plotësisht për të parandaluar përhapjen e koronavirusit gjatë muajit prill 2021, si dhe për të përmirësuar likuiditetin e kompanive që investojnë gjatë vitit 2021 (Qeveria e RMV, 2021).

Masat ekonomike dhe sociale të Qeverisë së RMV për parandalimin e krizës nga COVID-19 mund të gjinden në Anex A.

## **2.4 Pasqyra ekonomike e Maqedonisë së Veriut**

Në këtë pjesë do të fokusohemi kryesisht për faktorët makroekonomikë që ndikojnë në rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç janë: konsumi, shpenzimet qeveritare, borxhi publik si dhe tregtia e jashtme. Krijimi i borxhit në RMV daton që nga shpërbërja e Republikës Federale Sociale të Jugosllavisë, kur borxhet jugosllave u ndanë midis republikave pasardhëse. Pavarësia monetare që pasoi, si dhe problemet e shumta që u shfaqën në periudhën e tranzicionit, krijuan nevojën e huazimeve në mënyrë që vendi të jetë në gjendje të financojë nevojat e tij publike. Sipas Arsovski, Nenovski dhe Smiljkovski (2009) arsyet kryesore për krijimin e borxhit maqedonas kanë qenë kryesisht aktivitetet që kanë të bëjnë me: servisimin e një pjese të borxhit publik jugosllav që është ndërmarrë nga Maqedonia, rindërtimi dhe rehabilitimi për një pjesë të sistemit bankar maqedonas, depresioni ekonomik që po ndodhte gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, që merrej me çështjen e kursimeve në valutë të qytetarëve, të cilët kryesisht ishin depozituar në Bankën Kombëtare të Jugosllavisë, financimin e deficiteve të buxhetit etj.

Kjo pjesë fillon me një diskutim mbi konceptet dhe përkufizimet e konsumit, shpenzimeve qeveritare, borxhit publik si dhe tregtisë së jashtme si dhe një fokus specifik në krijimin e tyre, tendencat historike dhe nivelet e tyre aktuale. situatat në të cilat ka kaluar RMV gjatë dekadës së fundit dhe burimet kryesore të përdorura janë raportet vjetore të menaxhimit të borxhit publik të

përgatitura nga Enti shtetëror i statistikës së RMV, Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë, si dhe raportet e vendit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

### **2.4.1 Konsumi**

Në thelb, faktori më me ndikim në konsum është e ardhura, por nuk mund të ndikohet nga faktorë të tjerë të cilat kanë një ndikim të fortë tek konsumi i njerëzve. Vlera e blerjeve të kryera nga familjet për të blerë mallra dhe llojin e nevojave në një vit të caktuar quhet shpenzim i konsumit familjar ose në analiza makroekonomike më shpesh të referuara si konsum familjar. Të ardhurat e marra nga familja përdoren për të blerë ushqime, për të blerë rroba, financim i shërbimeve të transportit, pagesat për arsimimin e fëmijëve, pagesat e qirasë dhe blerja e një automjet, etj. Këto artikuj blihen nga familjet për të plotësuar nevojat e tyre dhe blerja quhet konsum, që është blerja e mallrave dhe shërbimeve për të kënaqur dëshirën për të zotëruar dhe përdorur mallrat.


Jo të gjitha transaksionet e kryera nga familjet janë klasifikuar si konsum familjar. Aktivitetet familjare për të blerë një shtëpi klasifikohen si investime. Për më tepër, disa nga shpenzimet e tyre, si pagimi për sigurimin dhe dërgimi i parave prindërve (ose fëmijëve që janë në shkollë) nuk klasifikohen si konsumi sepse nuk blejnë mallra dhe shërbime të prodhuara në ekonomi (Jhingan, 2012).

Teoria e konsumit e zhvilluar nga Milton Friedman në librin e tij të titulluar Teoria e Funksionit të Konsumit në vitin 1957 e njohur si teoria e të ardhurave të përhershme nga konsumi sugjeron se shpenzimi aktual i konsumit ose konsumi aktual varet nga të ardhurat aktuale dhe të ardhurat e parashikuara në të ardhmen (Nanga, 2005).

Brenda 18 viteve të fundit, niveli i konsumit familjar më i larti ka qenë në vitin 2008, me vlerë prej 401691MKD, ndërsa më i ulti ka qenë në vitin 2013 me vlerë prej 312901MKD. Pasi që në këtë studim qëllimi është të studiohet ndikimi i pandemisë COVID-19, e cila filloi në fund të vitit 2019 në nivel botëror, ndërsa në RMV në vitin 2020, në figure është paraqitur qart që ka ndikuar në uljen e konsumit familjar në nivelin e 341715MKD në vitin 2020, nga 349990MKD që ishte një vit më parë në vitin 2019. Gjitashtu ulje të konsumit familjar RMV ka përjetuar edhe

në vitin 2016 kur u ul në 333399MKD, nga 366451MKD sa ishte në vitin 2015 (Stat.gov.mk, 2021).


Figura 4. Niveli i konsumit familjar në RMV në periudhën 2010-2020



Burimi: Enti shtetëror i statistikës së RMV (2021). *Употребени средства според намената на потрошувачката, по СОICOP класификација и тип на домаќинство, по години*

Sipas të dhënave të fundit të Entit Shtetëror të statitiskës të RMV (2021b) të dhënat e konsumi final janë paraqitur si pjesë e produktit të brendshëm buto sipas metodës së shpenzimeve që nënkupton konsumin e fundit të produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në ekonominë vendase. Sipas të dhënave mund të vërehet që pandemia ka ndikuar që të ulet konsumi final në tremujorin e parë të vitit 2020 në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2019, për 14542 milion denarë ose për gati 10%. Në tremujorin e dytë të vitit 2020 fillon të ritet, si dhe në të tretën, mirpo vetëm në tremujorin e katërt konsumi është fillon të jetë më i lartë se sa ai i tremujorit të katërt të vitit 2019. Gjithashtu ulet në tremujorin e parë të vitit 2021 dhe pastaj përsëri vlerat e konsumit janë më të larta në tremujorin e dytë dhe të tretë se tremujori i fundit i vitit 2020 (shiko figurën 5).

Figura 5. Konsumi final në RMV (million denarë)




Burimi: Enti shtetëror i statistikës së RMV (2021b).



## 2.4.2 Prodhimi i brendshëm bruto në RMV

PBB konsiderohet si masa më e mirë e mirëqenies ekonomike, ndërsa nivelet reale të rritjes së PBB-së janë një masë e mirë e përparimit ekonomik të një vendi (Mankiw, 2004). Siç u tha më lart, pika fillestare për një përmbledhje të situatës ekonomike në Maqedoni është PBB dhe niveli i saj i vërtetë i rritjes si tregues. Përkatësisht, prodhimi i brendshëm bruto i Maqedonisë, kur është analizuar në terma absolut (me çmime aktuale), është rritur vazhdimisht në dekadën e fundit, mirpo është zvogluar në dy vitet e fundit. Në veçanti është rritur PBB e RMV nga një shumë prej 9412 milion dollar në vitin 2010 në shumën e të dhënave paraprake prej 12266 milion dollar në 2020. Çka është me interes në studimin tonë është impakti i pandemisë COVID-19 në ekonominë e RMV. Sipas të dhënave në 5 e vërejm që pandemia ka ndikuar negativisht në ekonominë e RMV sepse realisht në 2 vitet e fundit është ulur PBB në krahasim me vitin 2018 (World Bank, 2021).

Figura 6. PBB e Maqedonisë Veriore me çmime aktuale në dollar per periudhën 2010-2020




Burimi: *World Bank, World Development Indicators*

Që nga viti 2012 deri në vitin 2015, nivelet reale të rritjes së ekonomisë maqedonase kanë qenë pozitive dhe në rritje. Sipas Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë, ato ishin më të lartat në 2015 kur u raportua të qëndrojnë në 3.9%. Në vitin 2021 deri në kuartilin e 3 janë regjistruara ritme edhe me të lart duke arritur në 4.1% mirpo ky vit ende nuk ka përfunduar dhe pritet të shohim me çfar niveli të rritjes do të mbaroj (Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020a). Në fakt, si edhe më sipër mund të thuhet se rezultati dhe efektet e

pandemisë COVID-19 kanë ndikuar dukshëm në uljen e rritjes reale të ekonomisë duke arritur në -4.5%. Sidoqoftë, viti 2021 tregon rezultate të mira të rritjes ekonomike në vend. Duke analizuar ritmet reale të rritjes, ritmet e rritjes së PBB-së në çmimet aktuale dhe ritmet e rritjes së borxhit, është lehtësisht e vërejtur që normat e rritjes së borxhit kanë qenë shumë më të larta sesa ritmet e rritjes së aktivitetit ekonomik. Figura 6 tregon nivelet e rritjes së ekonomisë.


Figura 7. Nivelet e rritjes reale të ekonomisë së RMV per periudhën 2010 – 2021



Burimi: Ministry of Finance of the Republic of North Macedonia. (2020a). *Basic macroeconomic indicators*.

Që nga viti 2003 deri në vitin 2008, nivelet e rritjes së ekonomisë për kokë banori kanë qenë pozitive dhe në rritje. Sipas Bankës Botërore, ato rritja më e lartë ka qenë në vitin 2007 kur u raportua të rritet për 6.3%. Në vitin 2019 janë regjistruara ritme të larta në krahasim me dy vitet paraprake duke arritur në 3.9%. Në fakt, si edhe më sipër mund të thuhet se rezultati dhe efektet e pandemisë COVID-19 kanë ndikuar dukshëm në uljen e rritjes ekonomike për kokë banori duke arritur në -5.018% (shiko figurën 8).

Figura 8. Nivelet e rritjes ekonomike për kokë banori të RMV per periudhën 2003 – 2020



Burimi: World Bank (2021). World Development Indicators

### 2.4.3 Bilanci buxhetor i qeverisë të RMV

Në periudhën e 18 viteve të fundit, dmth nga viti 2003 deri vitin 2020, niveli mesatar vjetor i bilancit buxhetor të qeverisë si përqindje e GDP ka qenë -2.49, që nënkupton se qeveria më shumë ka harxhuar se sa ka pasur të hyra. Sa i përket vitit 2020 në krahasim me vitin 2019, bilanci buxhetor i qeverisë si përqindje e GDP është rritur nga -2% në -8.1%, nënkupton se totali shpenzimeve dukshëm është rritur në krahasim me totalin e të hyrave qeveritare. Pandemia COVID-19 dukshëm ka ndikuar në rritjen e deficitit buxhetor të RMV duke e rritur në vitin 2020 me 8.1% në krahasim me vitin paraprak të vitit 2019, si shkak i kësaj rritjeje kanë qenë masat qeveritare në përkrahje të qytetarëve dhe kompanive të RMV gjatë vitit 2020, dhe në anën tjetër mbyllja e përkoshme apo edhe bankrotimi i shumë firmave kanë ndikuar në zvoglimin e të hyrave qeveritare (Ministria e Financave e RMV, 2021a).

Figura 9. Bilanci buxhetor i qeverisë së RMV-së për periudhën 2003-2020 (si % e PBB-së)




Burimi: *Ministry of Finance of the RNM, Basic macroeconomic indicators, 2021a*

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i udhëhequr nga Bergljot Barkbu, kreu një vizitë virtuale të stafit me autoritetet e Maqedonisë së Veriut gjatë 6-17 majit të vitit 2021, për të diskutuar zhvillimet dhe politikat e fundit ekonomike. Në përfundim të vizitës, znj. Barkbu dha deklaratën e mëposhtme: “Politika fiskale duhet të mbetet mbështetëse për të ndihmuar në ringjalljen e rritjes, nxitjen e krijimit të vendeve të punës dhe mbrojtjen e shtresave vulnerabël. Një strategji fiskale afatmesme e besueshme mund të ndihmojë në trajtimin e nevojave të vendit për investime, ndërkohë që rindërton hapësirën për manovra fiskale. Plani i investimeve i qeverisë është ambicioz dhe duhet të shoqërohet me përmirësime të mëtejshme në menaxhimin e investimeve publike për të zgjidhur pengesat, për të përmirësuar efikasitetin e shpenzimeve dhe për të kufizuar rreziqet fiskale. Përpjekjet për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave do të krijojnë hapësirë për të rritur shpenzimet produktive në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe infrastruktura. Investimet publike të suksesshme do të nxisin rritjen dhe do të ndihmonin transformimin e ekonomisë, por për të ruajtur qëndrueshmërinë e borxhit, është thelbësore të kemi një strategji fiskale gjithëpërfshirëse, e cila ndër të tjera është e ndërtuar mbi supozime realiste të rritjes”.

#### **2.4.4 Borxhi publik dhe qeveritar i Maqedonisë Veriore**

Duke u bazuar në koceptin e borxhit të qeverisë së përgjithshme të RMV dhe borxhit publik, pritët që ato të jenë identike për sa i përket lëvizjeve të tyre të prirjeve historike. Borxhi i përgjithshëm i brendshëm i qeverisë është rritur nga 593.6 milion euro në vitin 2003 në 2159.6 milion euro në vitin 2020, ndërsa borxhi i përgjithshëm i jashtëm i qeverisë është rritur nga 1124.2 milion euro në vitin 2003 në 4323.7 milion euro në vitin 2020 (Ministry of Finance of R. North Macedonia, 2020d). Figura 7 tregon rritjen e përgjithshme të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të qeverisë. Është e qartë se barra e konsiderueshme e borxhit u rrit vazhdimisht nga viti 2003 e tutje, sidomos me një ritëm të shpejt të rritjes së borxhit në vitin 2020 si shkak i paraqitjes së pandemisë COVID-19.


Figura 9. Borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV në miliona euro për periudhën 2003-2020



Burimi: *Ministry of Finance of R. North Macedonia, (2020b), General government and guaranteed public debt*

Në qoft se analizohet në periudha më të shkurta kohore se një vit, dmth në kuartale nga viti 2019 deri në kuartalin e tretë të vitit 2021, për sa kemi arritur të sigurojm informata më të reja në lidhje me borxhin, mundë të vërehet që i njëjti është rritur nga 1655.4 milion euro në kuartalin e parë të vitit 2019 në 2320 milion euro në vitin kuartalin e tretë të vitit 2021. Sa i përket borxhit të përgjithshëm të jashtëm të qeverisë gjithashtu është rritur nga 2687.6 milion euro në kuartalin e parë të vitit 2019 në 3666.7 milion euro në kuartalin e tretë të vitit 2021 (Ministry of Finance of R. North Macedonia, 2020c). Figura 10 tregon rritjen e përgjithshme të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të qeverisë së RMV. Dukshëm vërehet që pandemia të ndikoj në rritjen e borxhit nga viti 2019 e tutje me nje ritëm shumë të shpejt.

Figura 10. Borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV në miliona euro për periudhën 2019-2021 në kuartile




Burimi: Ministry of Finance of R. North Macedonia, (2020c), General government and guaranteed public debt

#### 2.4.5 Tregtia e jashtme e Maqedonisë Veriore

Kërkesat e reduktuara dhe ndërprerjet në zinxhirët e vlerës, si pasojë e koronavirusit, pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në sektorin e jashtëm, veçanërisht në ekonominë si ajo e Maqedonisë, sektorët e prodhimit të së cilës janë më të integruar në zinxhirët e furnizimit global. Rezultatet e studimit të Gigov (2020) kanë treguar se rënia e aktivitetit ekonomik dhe e kërkesës në nivel global, përfshirë edhe në Bashkimin Evropian, e me këtë edhe në partnerët më të rëndësishëm eksportues maqedonas, ndikon drejtpërdrejt në sektorin e eksportit si dhe të importit në vend. Në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2020 vazhdimisht është rritur tregtia e jashtme duke përfshirë edhe eksportin edhe importin, mirpo paraqitja e pandemisë COVID-19 ka ndikuar negativisht në tregtinë e jashtme të RMV duke ulur atë. Në vitin 2019 eksporti është rritur me një ritëm më të ulët në krahasim me importin dhe e arrin bilancin tregtar në historinë e Maqedonisë -2.008 miliard Euro. Në vitin 2020 si shkak i pandemisë COVID-19 edhe importi por edhe eksporti ulen, gjë e cila ndikoj që edhe bilanci tregtar të zvoglohet në -1.8 miliard euro.

Figura 11. Bilanci tregtar i RMV-së për periudhën 2003-2020



Burimi: Ministry of Finance of the RNM, *Basic macroeconomic indicators*, 2021a

## Kapitulli 3

### 3.1 Literatura botërore mbi krizën ekonomike pas pandemisë Covid-19

Paraqitja e pandemisë Covid-19 ndikoj që të bëhen edhe shume hulumtime globale mbi ndikimin e saj në ekonominë e shteteve. Bazuar në një orientim normativ dhe një perspektivë



ndërdisciplinore, Sebastiano (2021) ka kryer një studim krahasues, duke përdorur metodologjinë e gjurmimit të procesit, midis përgjigjeve të BE-së për Eurozonën dhe Covid-19 për të vlerësuar nëse, pavarësisht rezultateve të ndryshme, proceset institucionale të vendimmarrjes dëshmojnë një ndryshim. Studimi arriti në përfundim se deficitet demokratik të BE-së mbetet, i cili merr karakteristika të veçanta në krizat ekonomike, duke siguruar një fuqi të madhe politike për shtetet hegjemoniste ekonomike, duke kufizuar kështu debatin ideologjik dhe duke bërë që interesi kombëtar të mbizotërojë mbi politizimin. Kjo përjetëson shndërrimin e pozicioneve strukturore ekonomike në pushtet politik në kurriz të pushtetit përfaqësues politik dhe demokracisë.

Artikulli i Fernandez et al. (2021) analizon politikën monetare të bankave kryesore qendrore gjatë asaj krizës ekonomike të krijuar nga pandemia COVID-19. Rritja e borxhit publik në shumë vende po financohet përmes blerjeve të aseteve nga autoritetet monetare. Megjithatë këto politika stimuluese paraprijnë pandeminë, ato janë rritur ndjeshëm pasi shumë qeveri përballen me nevoja të mëdha financimi. Shtetet kanë qenë në një mjedis me norma të ulëta interesi për vite me radhë dhe disa qeveri kanë lëshuar letra me vlerë të borxhit me norma negative. Përveç kësaj, rritja e kriptovalutave të decentralizuara, bazuar në teknologjinë blockchain, ka krijuar konkurrencë më të madhe në sistemin monetar ndërkombëtar dhe shumë qeveri e kanë konsideruar krijimin e monedhave virtuale të centralizuara, të njohura si monedhat dixhitale të bankës qendrore (CBDC). Autorët kanë analizuar disa raste përkatëse, me theks në projekte euro dixhitale. Metodologjia bazohet në analizën e evolucionit të variablave monetare. Artikulli rezulton ngjashmëri të madhe në politikat monetare ekspansioniste të bankave qendrore. Mosbesimi ndaj monedhave fiat është, për më tepër, një nga shkaqet e rritjes së çmimit të disa kriptomonedhave dhe arit.

Phillipson et al. (2020) paraqet një vlerësim të shpejtë të ndikimeve aktuale dhe të mundshme të ardhshme të shpërthimit të COVID-19 në ekonominë rurale duke pasur parasysh karakteristikat e tyre socio-ekonomike. Duke u mbështetur kryesisht në dëshmitë aktuale për Mbretërinë e Bashkuar, si dhe mësimet nga shpërthimi i sëmundjes së këmbëve dhe gojës në vitin 2001 dhe krizës financiare 2007/8, ai përshkruan efektet e mundshme kryesore të kërkesës dhe ofertës,

duke i kushtuar vëmendje situatës për bujqësinë, si dhe duke diskutuar implikimet për komunitetet rurale. Bëhet një dallim midis efekteve në bizneset që ofrojnë mallra dhe shërbime për jashtë shtetësisë në krahasim me konsumin brenda shtetësisë. Ndikimet e COVID-19 përjetohen ndryshe midis gjinive. Shumë nga profesionet e vijës së parë të prekura nga virusi ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë. Në përgjithësi, zinxhirët e furnizimit me ushqime në supermarkete janë treguar jashtëzakonisht elastike, duke u përballur mirë me sjelljen e stokut të konsumatorëve. Ekonomitë rurale me nivele më të larta të vetëpunësimit, dhe ndërmarrjet e vogla dhe mikro me aftësi të kufizuar të aftësisë paguese dhe parave të gatshme, ka të ngjarë të jenë më pak të përgatitura për të përballuar pasojat e shkaktuara nga COVID-19.

Pandemia e fundit e shkaktuar nga COVID-19 ka prekur globalisht lëvizshmërinë e transportit ajror, si dhe industrinë e linjave ajrore në përgjithësi. Kufizime të shumta janë zbatuar në transportin ajror, e cila potencialisht po çon drejt ndikimeve të rënda afatgjata në industrinë globale të linjave ajrore. Në këtë punim, lëvizshmëria e transportit ajror u analizua në lidhje me Evropën (BE) bazuar në të dhënat në dispozicion nga burimet përkatëse të lidhura me industrinë e linjave ajrore. Të dhënat u analizuan në periudha të veçanta nga janari deri në prill të vitit 2020, të cilat korrespondojnë me fillimin e pandemisë në BE dhe më vonë në zhvillimin e saj të plotë. Konkretisht, dy aeroporte u përzgjedhën në Kroaci si raste studimi për të analizuar ndikimin e COVID-19 në mënyrë më të plotë në lëvizshmëri së bashku me vlerësimin e gjurmës së karbonit gjatë pandemisë dhe një vit para gjendjes pandemike. Rezultatet zbuluan se COVID-19 gradualisht ndikoi në lëvizshmërinë e transportit ajror në BE, ku kulmi u arrit në prill me një reduktim të numrit të fluturimeve në rajonin e BE-së duke arritur më shumë se 89%. Trafiku i ngarkesave nuk u prek ndjeshëm nga pandemia, madje u rrit në disa raste për shkak të furnizimit me pajisje mjekësore në luftën kundër sëmundjes. Studimi i rastit i analizuar zbuloi zvogëlimin e lëvizshmërisë së transportit ajror për aeroportet e përzgjedhur në më shumë se 96%, gjë që ndikoi drejtpërdrejt në uljen e emetimeve të CO<sub>2</sub> në faktorin 1.81 për aeroportin tregtar të Zagrebit dhe 3.49 për aeroportin sezonal të Splitit (Nizetic, 2020).

Krahasuar me vlerësimet për PBB-në reale të ekonomisë globale, zona e euros ka përjetuar një goditje më të madhe në vitin 2020 dhe do të përjetojë një rimëkëmbje më të ngadaltë në 2021.

Ekonomia e BE-së përjetoi një goditje më të fortë se Kina dhe SHBA (2% rritje dhe -3.6% rënie respektivisht) në vitin 2020, ndërkohë që po mbetet dukshëm pas parashikimeve të rimëkëmbjes për Kinën (7.9 dhe 5.2% ndryshim vitin e kaluar për 2021 dhe 2022, respektivisht). Shkalla e papunësisë u rrit ndjeshëm në vitin 2020, si në BE-27 ashtu edhe në zonën e euros, duke arritur respektivisht 7.8% dhe 8.7% në periudhën korrik-shtator 2020. Në muajt e mbetur të vitit 2020, ajo u ul ngadalë. Një pikë pozitive, shkalla e papunësisë në BE është ende larg normave të regjistruara pas krizës financiare të vitit 2008. Prodhimi në industrinë në BE-27 përjetoi një rënie të mprehtë në mars dhe prill 2020 (respektivisht -11.1% dhe -20% ndryshim në periudhën e mëparshme), e cila përkoji me valën e parë të përhapjes së koronavirusit (De Vet, et al., 2021).

Analiza e (Almeida, 2021) përdor parashikimet ekonomike për vitin 2020 të lëshuara nga Komisioni Evropian në Vjeshtë 2019 dhe Pranverë 2020, dhe të një fakti të kundërt nën supozimin e ndryshimit pa politikë, për të analizuar ndikimin e krizës COVID-19 në të ardhurat e familjeve të BE-së. Për më tepër, analiza vlerëson efektin zbutës të masave diskrecionale të politikave fiskale të marra nga shtetet anëtare të BE -së. Autorët zbulojmë se pandemia COVID-19 ka të ngjarë të ndikojë në të ardhurat e disponueshme të familjeve në BE, me familjet me të ardhura më të ulëta të goditen më rëndë. Sidoqoftë, rezultatet tregojnë se për shkak të ndërhyrjes në politikë, ndikimi i krizës pritet të jetë i ngjashëm me atë të përjetuar gjatë krizës financiare 2008-2009. Në detaje, rezultatet tregojnë se masat diskrecionale të politikës fiskale do të luajnë një rol të rëndësishëm zbutës, duke zvogëluar madhësinë e humbjes së të ardhurave (nga -9.3% në -4.3% për të ardhurat e disponueshme mesatare të barabarta të disponueshme), regresivitetin e saj dhe zbutjen e ndikimit të varfërisë të pandeminë. Autorët konkludojmë se ndërhyrjet e politikave janë, pra, instrumentale në zbutjen e ndikimit të krizës në pabarazinë dhe varfërinë.

### **3.2 Literatura e RMV-së mbi krizën ekonomike pas pandemisë Covid-19**

Gjatë pregaditjes së këtij punimi të masterit ne hasëm në mungesë të theksuar të literaturës sa i përket ndikimit të COVID-19 në ekonominë e Maqedonisë së Veriut, gjë që ishte edhe ndër shkaqet që pikërisht këtë problematikë ta kemi çështje hulumtimi. Stojkovski et al. (2020) hetoj ndikimin e pandemisë COVID-19 në industrinë e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së

Veriut gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Duke përdorur modele dhe të dhëna autoregresive sezonale për 11 klasa sigurimi, autorët zbulojmë se aktiviteti i sigurimit u tkurr me më shumë se 10% në krahasim me atë që pritej. Humbja totale në industri ishte, megjithatë, shumë më pak se shumica e fondeve të vëna në dispozicion nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Kjo ndodhi sepse pandemia shkaktoi ndryshime në strukturën e aktivitetit - pjesa e klasës së automjeteve motorike ra në kurriz të klasave të pronës.

Mitev dhe Drangovska (2021) analizat e ndikimeve ekonomike të krizave i kanë bazuar në lëvizjen e treguesve kryesorë makroekonomikë si: normat e rritjes së PBB -së, normat e papunësisë, borxhi bruto, etj. Analizat e ndikimeve shoqërore të krizave fokusohen në uljen e të ardhurave, rritjen e pabarazisë në shpërndarja e të ardhurave dhe rritja e varfërisë. Shkalla e rritjes së PBB -së është ulur me 4.5% në 2020, një rënie prej gati 10% në prodhimin industrial është arritur dhe ndikimet negative janë të dukshme në pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë. Për më tepër, shkalla e papunësisë nuk ka ndryshuar në mënyrë dramatike në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, niveli i punësimit dhe niveli i aktivitetit janë ulur në krahasim me vitin 2019, që do të thotë se kriza ka ndikuar edhe në tregun e punës. Kriza ka rritur shkallën e varfërisë në vend dhe në të njëjtën kohë sipas disa vlerësimeve kombëtare, pabarazitë e të ardhurave janë rritur shumë. Stimuli financiar i qeverisë ndihmoi në zbutjen e ndikimit negativ në tregun e punës dhe në zbutjen e ndikimit socio-ekonomik të krizave në Maqedoninë e Veriut. Por hapësira fiskale si rezultat i masave të zbatuara është relativisht e kufizuar, pasi deficiti i përgjithshëm buxhetor arriti -8.5% dhe borxhi publik arriti pothuajse 60% të PBB -së.

Petreski, M. (2021) simuloi efektin e varfërisë të pandemisë Covid-19 në Maqedoninë e Veriut dhe analizoi fuqinë e kursimit të të ardhurave të tre masave kryesore të qeverisë: skema e mbajtjes së punësimit, mbështetja e relaksuar e të ardhurave minimale të garantuara dhe pagesat e parave të gatshme. Në këtë përpjekje, skenarët e kundër-faktit janë simuluar duke përdorur MK-MOD, Modelin e Mikrosimulimit të Taksave dhe Përfitimeve të Maqedonisë, duke përfshirë të dhëna aktuale mbi madhësinë e goditjes nga tremujori i dytë i vitit 2020. Rezultatet sugjerojnë që pa ndërhyrjet e qeverisë, një shtesë prej 120,000 njerëz do të ishin shtyrë në varfëri nga COVID-19, ku 340,000 ishin tashmë të varfër para pandemisë. Nga 120,000 të sapo varfëruar,

rreth 16,000 do të ishin shtyrë në varfëri të skajshme. Stabilizuesit automatikë të qeverisë punuan për të mbrojtur njerëzit më të varfër, megjithëse ata ishin qartë pro-femërore. Në tërësi, masat e analizuara të qeverisë rikuperuan më shumë se gjysmën e humbjes së të ardhurave, e cila frenoi efektin e rritjes së varfërisë dhe nxori 34,000 njerëz shtesë nga varfëria ekstreme. Masa e mbajtjes së punësimit ishte regresive dhe pro-mashkullore; Relaksimi i të ardhurave minimale të garantuara (përfshirë stabilizuesit automatikë) ishte progresiv dhe pro-femëror, dhe mbështetja e njëhershme ka qenë pro të rinjve.

Alili (2020) synon të vlerësojë ndikimin e shpërthimit të COVID-19 në tregun e punës duke analizuar sektorët më të prekur dhe qeveria e matur me qëllim parandalimin e humbjeve të vendeve të punës. Shumë biznese të vogla dhe të mesme tashmë kanë mbyllur operacionet e tyre ose kanë zvogëluar numrin e punonjësve. Industritë më të prekura për shkak të shpërthimit të COVID-19 janë industria e turizmit dhe industritë e orientuara nga eksporti, përfshirë sektorin e tekstilit. Për të zbutur pasojat e COVID-19, Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar masa për mbështetjen e firmave të cilat synojnë të mbajnë vende pune, të ruajnë stabilitetin social dhe të ndihmojnë qytetarët e prekur nga kriza. Karakteristikat specifike të tregut lokal të punës duhet të merren parasysh kur specifikohen kriteret e përshtatshmërisë dhe ndërmarrja e masave të reagimit ndaj krizave.

Studimi i Svrtinov et al. (2020) rezultoj që së përgjigje të mbrojtjes nga Covid-19, të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë zbatuar masa të rrepta të distancimit shoqëror. Aeroportet ndërkombëtare në të gjitha vendet u mbyllën për trafikun e udhëtarëve. Udhëtimet dhe tubimet shoqërore janë kufizuar ose ndaluar, dhe shkollat dhe universitetet janë mbyllur. Kriza COVID-19 ka pasojat të rënda për ekonominë e këtyre vendeve. Të dyja, oferta agregate dhe kërkesa agregate ranë me shpejtësi. Rënia e aktivitetit ekonomik po ndërlikon edhe financat publike dhe zgjeron nevojat për financim të qeverive. Për më tepër, turizmi veror gjithashtu ra. Konsumi dhe investimet jo thelbësore vonohen derisa të zgjidhet pasiguria e lidhur me krizën. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë njoftuar paketa të mëdha fiskale që variojnë nga 1 deri në 7 përqind të PBB -së për të mbështetur qytetarët dhe bizneset e tyre. Autorët kanë konkluduar që kriza e Corona do të ketë pasojat të rënda për ekonominë e Ballkanit Perëndimor dhe se

rimëkëmbja do të varet nga masat e marra nga autoritetet. Është sfidë shumë e rëndësishme për qeveritë që të menaxhojnë likuiditetin nga afër për të shmangur përshkallëzimin e mëtejshëm të krizës, duke ofruar ndihmë për ata që kanë më shumë nevojë.

Svrtinov et al. (2021) kanë eksploruar efektin e krizës COVID-19 në bankat komerciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ata kanë përdorur të dhëna nga pasqyrat financiare të bankave për të gjetur nëse ka ndryshime në përfitimin e bankave, si dhe ekspozimin e bankave ndaj likuiditetit dhe rrezikut të kredisë në periudhën e krizave të Corona dhe para krizave. Për më tepër, autorët kanë eksplorojmë nëse ka ndryshime në potencialin kreditor dhe depozitues të bankave dhe më tej ka një rritje të kredive me probleme. Gjithashtu kanë konkluduar se edhe sektori bankar është përballur me disa sfida, ai ruajti stabilitetin e tij dhe kontribuoi në zbutjen e pasojave të krizës së koronës. Kjo, nga njëra anë, është rezultat i besimit të publikut në sistemin bankar, por, nga ana tjetër, është për shkak të reagimit të shpejtë të Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2020, sistemi bankar bëri një fitim më të lartë në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat nga interesi ishin më të rëndësishmet në strukturën e të ardhurave totale dhe nuk u ulën në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019. Bankat siguruan rritje solide të kredive dhe depozitave, si dhe u menaxhuan siç duhet rrezikun e tyre të kreditit dhe likuiditetit. shtë e rëndësishme të theksohet se bankat kanë mbajtur një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm dhe solid, i cili është një nga shtyllat kryesore të stabilitetit të sistemit bankar, veçanërisht i rëndësishëm në kohë krize. Gjithashtu nuk ka pasur rritje të kredisë rreziku, përkundrazi ka pasur një rënie në përqindjen e huave me probleme. Kjo është kryesisht për shkak të masave rregullatore të marra nga Banka Kombëtare në fushën e administrimit të rrezikut të kredisë dhe futjes së mundësisë së shtyrjes së përkohshme të huave.

Hulumtimi i Kodri dhe Jusufi (2020) rezultoi që nga rasti i parë i regjistruar i koronavirusit në shkurt, numri i rasteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rritur vazhdimisht. Duke pasur parasysh situatën aktuale, një plan trefazor për zvogëlimin e masave parandaluese të virusit u miratua nga qeveria maqedonase. Masat për të parandaluar përhapjen e Covid-19 kanë ngadalësuar aktivitetin ekonomik, i cili nga ana e tij ka filluar të ndikojë negativisht në buxhetin

kombëtar. Gjetjet e këtyre metodave tregojnë se kriza e Covid 19 ka ndikim negativ në treguesit kryesorë makroekonomikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas Gigov (2020) kërkesa e zvogëluar dhe ndërprerjet në zinxhirët e vlerës, si rezultat i COVID-19, pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në sektorin e jashtëm, veçanërisht në ekonominë si Maqedonia, sektorët e prodhimit të të cilëve janë më të integruar në zinxhirët global të furnizimit. Prandaj, qëllimi kryesor i punimit është të shihet në çfarë mase dhe në cilat segmente kushtet e reja kanë reflektuar në eksportet dhe importet në ekonominë maqedonase, dhe të rishikojë masat dhe aktivitetet e ndërmarra me qëllim zbutjen e sfidave afatshkurtra dhe lehtësimin tregtia ndërkufitare. Punimi analizon trendin dhe ndryshimet që ndodhin si në anën e importit ashtu edhe të eksportit, në përgjithësi, nga produktet e përzgjedhura dhe nga vendet. Të dhënat në përgjithësi i referohen 5 viteve të fundit. Për analiza më të veçanta dhe më specifike, ato mbulojnë periudhën nga janari 2019 deri në qershor 2020, në baza tremujore. Metodot kryesore të kërkimit të përdorura janë: analiza dhe sinteza, metoda statistikore, historike dhe induktive-deduktive. Rezultatet kanë treguar se rënia e aktivitetit ekonomik dhe kërkesës në nivel global, përfshirë në Bashkimin Evropian, dhe kështu në partnerët më të rëndësishëm të eksportit maqedonas, ndikon drejtpërdrejt në sektorin e eksportit në vend. Ekonomia gjithashtu përballet me probleme serioze të importit, veçanërisht për shkak të varësisë së saj të madhe nga materialet e nevojshme për proceset e prodhimit industrial që zakonisht importohen nga tregjet më të goditura në Evropë. Masat tregtare janë krijuar kryesisht për të shmangur barrierat e panevojshme në tregti dhe prishjen e zinxhirëve të furnizimit global.

Studimi i bërë nga Spaseska et al. (2020) rezultoj që epidemia e virusit Covid-19 që ka goditur botën e tregjeve të aksioneve kanë dëmtuar gjithashtu edhe tregjet financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Epidemia e virusit Covid-19 që ka goditur tregjet globale të aksioneve ka dëmtuar edhe tregun e brendshëm të aksioneve, më së shumti në indeksin MBI10, i cili përmban dhjetë letrat me vlerë më likuide të kompanive të listuara. Ky indeks u zhyt me 22.43% në Mars 2020 i cili është në rënie të konsiderueshme, duke pasur parasysh se në 5 vitet e fundit MBI10 u karakterizua me rritje të vazhdueshme dyfishitore vjetore. Kompanitë e naftës, agjencitë e udhëtimit, prodhuesit ishin gjithashtu të ekspozuar ndaj shpërthimit të koronës, aksionet e tyre

ishin gjithashtu në rënie duke humbur mbi 10% të vlerës së aksioneve të tyre. Sidoqoftë, për sa i përket COVID 19, vlera e aksioneve të bankave u regjistrua në rritje.

Sipas të gjitha studimeve paraprake mund të rezultoj që padyshim pandemia Covid-19 ndikoj negativisht në ekonominë e Maqedonisë së Veriut edhe atë në të gjitha sektorët duke përfshirë: sektorin e sigurimeve; uljen e normave të rritjes së PBB -së, normat e papunësisë, borxhin bruto; tregun e punës; ndikimi negativë është shfaqur edhe në vendet e Ballkanit perëndimor; në bankat komerciale; zvogëlimi dhe ndërprerja në zinxhirët e vlerës, etj.

## **Kapitulli 4. Metodologjia, rezultatet empirike dhe diskutimi**

### **4.1 Hyrje**

Në këtë kapitull diskutohet për metodologjinë e hulumtimit, rezultatet empirike dhe diskutohen rezultatet e gjetura në studim. Përfshinë modelin e hulumtimit, të dhënat, teknikën e mbledhjes së të dhënave, specifikimin e modelit, modelin linear, testin e regresionit, korrelacionin, si dhe përfundimin dhe rekomandimet.

### **4.2 Modeli i hulumtimit**

Kryesisht në këtë hulumtim, është përdorur hetimi empirik, që ka të bëjë me mënyrën sistematike për t'u marrë me objektin e studimit. Hulumtimi në një masë të madhe varet nga studimi kuantitativ i të dhënave në bazë regresionit linear mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 në ekonominë e Republikës së Maqedonisë Veriore.

### **4.3 Të dhënat**

Ky studimi është përqëndruar në të dhënat e serive kohore për gjashtë variabla makroekonomike për periudhën 2003 deri në 2020. Mugenda (2003), shpjegon se popullacioni i synuar duhet të



ketë disa karakteristika të vëzhguara, për të cilat studiuesi synon të përgjithësojë rezultatet e studimit.

#### **4.4 Metodologjia e hulumtimit**

Burimi i të dhënave: Studimi ka përdorur të dhëna të serive kohore vjetore për periudhën 2003-2020 që përkthehen në 18 vrojtime. Të dhënat për konsumin, borxhin e përgjithshëm të brendshëm dhe të jashtëm të qeverisë së RMV, bilancin e buxhetit të qeverisë, tregtisë së jashtme si dhe nivelet e rritjes reale të ekonomisë së RMV që janë marrë nga Ministria e Financave e RMV, siç janë paraqitur në figurat në Kapitullin e dytë.

#### **4.5 Specifikimi i modelit**

Për aplikim të të dhënave në procesimin e tyre është përdorur softveri statistikor SPSS në mënyrë që të arrihet në output të të dhënave dhe analizohen të dhënat e grumbulluara, sipas edhe të cilës do të vërtetohen hipotezat e parashtruara në këtë hulumtim. Në këtë kapitull të katërt analizohen të dhënat dhe bëhet diskutimi i të dhënave duke përdorur këto modele: modeli linear, testin e regresionit, ANOVA dhe korelacioni.

#### **4.6 Modeli linear**

Modeli linear paraqet një nga metodat më të aplikuara në analizën e dy variablave për shkak të thjeshtësisë dhe saktësisë së të dhënave duke përfshirë:

- Variablën  $y$ , që paraqet variablën e varur nga variablat  $x$ , që në rastin tonë variabël e varur është paraqitur rritja ekonomike, dhe
- Variablat  $x$ , që paraqesin variablat e pavarura nga variabla  $y$ , që në rastin tonë variabla të pavarura janë: Konsumi, Borxhi i përgjithshëm i Brendshëm dhe i Jashtëm i qeverisë së RMV-së, bilanci i buxhetit të qeverisë si dhe bilanci tregtar i RMV.

Modeli linear që zhvillohet në këtë rast në bazë të këtyre të dhënave është si më poshtë:

$$y = B_0 + B_1x_1 + B_2x_2 + B_3x_3 + B_4x_4 + B_5x_5 + u_i$$

ose më saktësisht është:

$$GDP_{grt} = \beta_0 + \beta_1 \ln C_t + \beta_2 \ln DoDt + \beta_3 \ln ExDt + \beta_4 GBB_t + \beta_5 TB_t + \mu t$$

ku,

- $GDP_{grt}$  = Norma vjetore e rritjes ekonomike në kohë t (e bazuar në normën vjetore të rritjes së Prodhimit të Brendshëm Bruto për kokë banori)
- $\ln C_t$  = Logaritmi natyror i Konsumit familjar në kohë t (e bazuar në mjetet e përdorura sipas qëllimit të konsumit)
- $\ln ExDt$  = Logaritmi natyror i Borxhit të Jashtëm në kohë t
- $\ln DoDt$  = Logaritmi natyror i Borxhti të Brendshëm në kohë t
- $GBB_t$  = Bilanci buxhetor i qeverisë në kohë t (i bazuar si % e PBB)
- $TB_t$  = Bilanci tregtar në kohën t
- t = koha
- $\epsilon t$  = termi i gabimit supozohet të jetë shpërndarë normalisht dhe në mënyrë të pavarur me mesataren zero dhe variancën konstante.
- $\beta_0$  = paraqet konstantën
- $\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5$  = paraqesin vlersimet e parametrave të ndryshimit të rritjes ekonomike.

#### 4.7 Korelacioni

Si analizë shtesë në këtë hulumtim janë bërë analizat e korelacioneve të variablave të pavarura dhe variablës së varur, të cilat janë studiuar nëpërmjet korelacionit Pearson të paraqitur në tabelën 5 e paraqitur më posht. Qëllimi i studimit me këtë lloj korelacioni është sepse korelacioni më i zakonshëm është ai i Pearson-it e cila përdoret për matjen e lidhjeve lineare midis dy variablave. Korelacionet e variablave variojnë nga vlera -1 (korelacion perfekt negativ) deri në vlerën +1 (korelacion perfekt pozitiv). Duke i analizuar korelacionet e studiuar mund të rezultojmë se disa variabla të pavarura kanë korelacione pozitive me variablën e varur, ndërsa disa variabla të pavarura kanë korelacione negative me variablën e varur. Psh. me rritjen e bilanci buxhetor i qeverisë të RMV do të kemi normë të rritjes ekonomike gjë që është e pranueshme, sepse bilanci buxhetor i qeverisë jep stimulim të rritjes ekonomike.

Gjithashtu në tabelën 5 mund të vërehet që sipas korelacionit Pearson, variablat e pavarura si bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV-së janë statistikisht të rëndësishme për parashikimin e normës së rritjes ekonomike në RMV pasi që vlera e signifikancës së tyre është më e vogël se vlera  $p$  që është 0.05, edhe ate 0.00, 0.046 si dhe 0.026.

Tabela 5. Korelacioni Pearson

|                 | Growth_rate                      | Consumption | Domestic_general_government_debt | External_general_government_debt | Government_budget_balance | Trade_balance |
|-----------------|----------------------------------|-------------|----------------------------------|----------------------------------|---------------------------|---------------|
| Pearson         | Growth_rate                      | 1.000       |                                  |                                  |                           |               |
|                 | Consumption                      | .371        | 1.000                            |                                  |                           |               |
| Correlation     | Domestic_general_government_debt | -.409       | -.394                            | 1.000                            |                           |               |
|                 | External_general_government_debt | -.464       | -.342                            | .948                             | 1.000                     |               |
|                 | Government_budget_balance        | .813        | .377                             | -.635                            | -.690                     | 1.000         |
|                 | Trade_balance                    | .325        | -.031                            | -.490                            | -.620                     | .579          |
| Sig. (1-tailed) | Growth_rate                      | .           |                                  |                                  |                           |               |
|                 | Consumption                      | .065        | .                                |                                  |                           |               |
|                 | Domestic_general_government_debt | <b>.046</b> | .053                             | .                                |                           |               |

|   |                                  |      |      |      |      |      |    |
|---|----------------------------------|------|------|------|------|------|----|
|   | External_general_government_debt | .026 | .083 | .000 | .    | .    | .  |
|   | Government_budget_balance        | .000 | .062 | .002 | .001 | .    | .  |
|   | Trade_balance                    | .094 | .452 | .019 | .003 | .006 | .  |
| N | Growth_rate                      | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |
|   | Consumption                      | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |
|   | Domestic_general_government_debt | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |
|   | External_general_government_debt | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |
|   | Government_budget_balance        | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |
|   | Trade_balance                    | 18   | 18   | 18   | 18   | 18   | 18 |

#### 4.8 Testi i regresionit

Testi i regresionit është marrë si bazë për të testuar të dhënat tona në eksplorim. Testi i regresionit përcakton zbulimet e eksplorimit ku e bazuam përfundimin e këtij studimi dhe propozimet tona. Testi i regresionit ishte në thelb në regresion linear. Ne e ndërtuam punën në disa faza të regresionit për të zbuluar vlefshmërinë dhe për të mbajtur një ndarje jetike nga çdo shenjë e gabuar e cila do të ndikojë në të gjithë punën, përmbledhjen, përfundimin dhe sugjerimet. Regresioni është rezultati që miraton vlefshmërinë e punës dhe reagimin ndaj deklaratës së problemit kur kërkohet çdo strategji dhe nuk ka ndodhur asnjë çështje mes kohës së kaluar për të ekzaminuar informacionin e ndryshoreve. Saktësisht kur bëhet ekzaminimi i regresionit linear, ekziston mundësia që tabela të ndryshme të paraqiten për rirregullimet e rezultateve të krijuara nga regresioni linear, ekzaminimi është i detyruar vetëm në tabela, për shembull, (a) Diagrami Model (b) Anova dhe (c) Koeficientët. Përmbledhja e modelit tregon R katror dhe R katror të rregulluar. R katror është gjithmonë i vlefshëm për të kuptuar dhe eksploruar punën e regresionit. Një pjesë e konsiderueshme e kohës është parashikuar që R katror të jetë i lartë në mënyrë që të tregojë se ka larmi të lartë me anë të ekzaminimit të regresionit pasi që sa më e dukshme është luhatja aq më afër është informacioni në linjën e regresionit. Në të njëjtën mënyrë, nëse një model mund të japë 100% të lëvizjes (Variancës) në një model regresioni, numrat e përshtatshëm do të ishin të njëjtë me numrat e shikuar dhe,

kështu, çdo informacion do të pajtohej me linjën e regresionit të montuar duke e bërë modelin kështu e jashtëzakonshme dhe e mjaftueshme.

Pavarësisht, nëse R katror është i ulët, nuk nënkupton që puna është absolutisht e tmerrshme. Në fakt, R katror është përgjithësisht nën gjysmën (.500) posaçërisht kur përfshin parashikimin e individëve dhe sjelljen e tyre se ai ka gjendje anormale të disponimit fiziologjik në shkencat sociale. Si ANOVA ashtu edhe Koefficientët sqarojnë rëndësinë e regresionit dhe natyrës pozitive ose negative në anët e beta dhe prirjeve.

Tabela 1. Variablave të vendosura/larguara

| Model <sup>a</sup> | Variables Entered   | Variables Removed | Method |
|--------------------|---|-------------------|--------|
| 1                  | Trade_balance,<br>Consumption,<br>Domestic_general_government_debt<br>, Government_budget_balance,<br>External_general_government_debt <sup>b</sup> |                   | Enter  |

a. Dependent Variable: Growth\_rate

b. All requested variables entered.

Tabela 1 demonstron që variabël e varur është norma e rritjes ekonomike dhe variabla të pavarura janë bilanci tregtar, konsumi familjar, Bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV-së për periudhën kohore 2003-2020.

Tabela 2. Përmbledhja e modelit të regresionit

| Model <sup>b</sup> | R                 | R Square | Adjusted R Square | Std. Error of the Estimate | Durbin-Watson |
|--------------------|-------------------|----------|-------------------|----------------------------|---------------|
| 1                  | .843 <sup>a</sup> | .711     | .590              | 1.69103580353              | 1.572         |

a. Predictors: (Constant), Trade\_balance, Consumption, Domestic\_general\_government\_debt, Government\_budget\_balance, External\_general\_government\_debt

b. Dependent Variable: Growth\_rate

Në tabelën e dytë është bërë përmbledhja e regresionit duke përfshirë edhe testin e Durbin-Watson që paraqet test për autokorrelacionin në mbetjet nga një analizë e regresionit statistikor. Statistika Durbin-Watson gjithmonë do të ketë një vlerë midis 0 dhe 4. Vlerat nga 0 në më pak se 2 tregojnë autokorrelacionin pozitiv dhe vlerat nga 2 në 4 tregojnë autokorrelacionin negativ. Pasi që rezultati në modelin tonë është 1.572 nënkupton që egziston lidhshmëri pozitive ne mes të variablës së varur dhe variablave të pavarura. Gjithashtu Tabela 2 përfaqëson korelacionin, gjegjësisht marrëdhëniet ndërmjet variablës së varur dhe atyre të pavarur, që është paraqitur si R me koeficient 0.843, gjegjësisht ndërlshja është shumë e fort positive ndërmjet tyre. Në tabelën 2 poashtu është paraqitur regresioni me R katror dhe R katror e rregulluar që është 71.1% (0.711) dhe 59% (0.59), kjo nënkupton që këto rezultate përbëjnë shumicën e variancës në normën e rritjes ekonomike të RMV-së në këtë studim, që paraqet një parashikim shumë të mirë pasi që është mbi 70% e variabilitetit. Testi i regresionit tregon që R katrore me vlerë 71.1% nënkupton ndryshueshmërinë në normën e rritjes ekonomike që mund të llogaritet nga bilanci tregtar, konsumi familjar, bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV-së për periudhën kohore 2003-2020.

Tabela 3. Koeficientët

| Model <sup>a</sup>               | Unstandardized Coefficients |            | Standardized Coefficients | t     | Sig. |
|----------------------------------|-----------------------------|------------|---------------------------|-------|------|
|                                  | B                           | Std. Error | Beta                      |       |      |
| 1 (Constant)                     | -27.233                     | 98.165     |                           | -.277 | .786 |
| Consumption                      | 2.208                       | 7.520      | .055                      | .294  | .774 |
| Domestic_general_government_debt | 1.823                       | 2.663      | .364                      | .685  | .507 |
| External_general_government_debt | -1.327                      | 3.163      | -.250                     | -.419 | .682 |
| Government_budget_balance        | 1.262                       | .304       | .975                      | 4.148 | .001 |
| Trade_balance                    | -.001                       | .002       | -.215                     | -.906 | .383 |

a. Dependent Variable: Growth\_rate

Në tabelën 3 janë paraqitur koeficientët e pastandardizuar, të cilët paraqesën efektin e ndryshimit për një njësi të variablave të pavarura në variablën e varur që në rastin paraprak është norma e rritjes ekonomike në RMV. Rezultatet e fituara janë si në vijim:

- Konstanta është -27.233, që nënkupton koeficientin e vlerësimit në qoftëse bilanci tregtar, bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i

qeverisë së RMV-së si dhe konsumi familjar i RMV-së janë zero, atëherë norma e rritjes ekonomike në RMV do të jetë negative, pra do të ulet për 27.233%.

- Konsumi familjar në RMV është 2.208, që nënkupton se me rritjen e konsumit familjar për një njësi, në këtë rast konsumi familjar është i shprehur në denar, atëherë norma e rritjes ekonomike në RMV do të rritet mesatarisht për 2.208%
- Borxhi i përgjithshëm i brendshëm është 1.823, që nënkupton se me rritjen e borxhit të përgjithshëm të brendshëm për një milion euro, pasi që e kemi shprehur borxhin në vlerë një milion euro, atëherë norma e rritjes ekonomike në RMV do të rritet mesatarisht për 1.823%.
- Borxhi i përgjithshëm i jashtëm është -1.327, që nënkupton me rritjen e borxhit të përgjithshëm të jashtëm për një milion euro, pasi që e kemi shprehur borxhin në vlerë një milion euro, atëherë norma e rritjes ekonomike në RMV do të ulet mesatarisht për 1.327%.
- Bilanci buxhetor i qeverisë si % e PBB-së është 1.262, që nënkupton me rritjen e bilancit buxhetor të qeverisë për një përqind, norma e rritjes ekonomike në RMV do të rritet mesatarisht për 1.262%, ceteris paribus.
- Bilanci tregtar është -0.001, që nënkupton me rritjen e bilancit tregtar për një milion euro, pasi që e kemi shprehur borxhin në vlerë një milion euro, atëherë norma e rritjes ekonomike në RMV do të ulet mesatarisht për 0.001%, ceteris paribus.

Pasiqë në tabelën 2 është bërë përmbledhja e modelit të regresionit në përgjithësi ose variablat e pavarura janë paraqitur në grup, në tabelën 3 gjithashtu janë bërë analiza shtesë për koeficientët e çdo variable të pavarur individualisht, edhe atë nëse një variabël e caktuar është signifikante (e rëndësishme) në vetvete gjë që fokusohemi në vlerat  $p$  të tyre. Nga variablat e pavarura statistikisht të rëndësishme për parashikimin e normës së rritjes ekonomike në RMV paraqitet vetëm një variabël e pavarur pasi që vlera e signifikancës është më e vogël se vlera  $p$  që është 0.05, edhe bilanci buxhetor i qeverisë me vlerë 0.001. Sipas kësaj mund të konkludojm se vetëm

bilanci buxhetor i qeverisë si variabël e pavarur shpjegon një varianc unike të normës së rritjes ekonomike në RMV.

Tabela 4. Analiza e variaces

| Model <sup>a</sup> |            | Sum of Squares | df | Mean Square | F     | Sig.              |
|--------------------|------------|----------------|----|-------------|-------|-------------------|
| 1                  | Regression | 84.353         | 5  | 16.871      | 5.900 | .006 <sup>b</sup> |
|                    | Residual   | 34.315         | 12 | 2.860       |       |                   |
|                    | Total      | 118.668        | 17 |             |       |                   |

a. Dependent Variable: Growth\_rate

b. Predictors: (Constant), Trade\_balance, Consumption, Domestic\_general\_government\_debt, Government\_budget\_balance, External\_general\_government\_debt

Gjithashtu në tabelën 4 mund të vërehet që në mënyrë të përbashkët variablat e pavarura janë statistikisht të rëndësishme për parashikimin e normës së rritjes ekonomike në RMV pasi që që vlera e signifkancës është më e vogël se vlera  $p$  që është 0.05, edhe ate vetëm 0.006.

#### 4.9 Përfundimi dhe rekomandimet

Rritja reale ekonomike ka qenë gjithashtu një çështje shqetësuese për Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e paraqitjes së pandemisë COVID-19. Edhe pse krahasuar me vendet e tjera Maqedonia e Veriut konsiderohej se po merrte mjaft mirë krizën globale financiare, paraqitja e pandemisë COVID-19 si në të gjitha shtetet e botës ndikoi dukshëm në uljen e rritjes ekonomike të RMV. Rritja ekonomike dukshëm u zvoglua në vitin 2020 dhe 2021 në krahasim me periudhën kohore para këtyre viteve.

Në këtë studim gjithashtu u vërejt që literatura ekzistuese identifikon ndërlidhshmërinë midis pandemisë COVID-19 dhe normave të rritjes ekonomike në të gjitha shtetet. Në këtë punim është studiuar roli i pandemisë COVID-19 në rritjen ekonomike duke u bazuar në atë se RMV është në perfundim të procesit të tranzicionet dhe se vendi është në integrim të strukturave Veri Atlantike. Në hulumtim janë paraqitur shume qëllime, dhe ndër qëllimet kryesore është analiza empirike e ndikimit të pandemisë COVID-19 në rritjen ekonomike për të hetuar nëse pandemisë COVID-19 ka lidhshmëri në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në mënyrë që të vërtetohet validiteti i hipotezave, hulumtimi bazohet në të dhëna të publikuara nga institucione relevante qeveritare të RMV-së si dhe ndërkombëtare, edhe ate kryesisht nga



Ministria e Financave e RMV-së. Si pjesë aplikative është përdorur softveri statistikor SPSS në mënyrë që të arrihet në output të të dhënave dhe analizohen të dhënat e grumbulluara, sipas edhe të cilës janë vertetuar hipotezat e parashtruara në këtë hulumtim. Në kapitullin e katërt janë analizuar të dhënat duke përdorur këto modele: modeli linear, testin e regresionit, ANOVA dhe korelacioni. Gjithashtu modelet e caktuara do kanë edhe shpjegimet e veta në mënyrë që më mirë të komentohen dhe kuptohen nga lexuesit. Studimi ka përdorur të dhëna të serive kohore vjetore për periudhën 2003-2020 që përkthehen në 18 vrojtime. Të dhënat për bilancin tregtar, bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV-së si dhe konsumi familjar i RMV-së dhe nivelet e rritjes së ekonomisë së RMV që janë marrë nga Ministria e Financave e RMV janë paraqitur në figurat në Kapitullin e dytë.

Në këtë studim testi i regresionit tregon që R katrore me vlerë 71.1% nënkupton ndryshueshmërinë në normën e rritjes ekonomike mund të llogaritet nga bilanci tregtar, bilanci buxhetor i qeverisë, borxhi i përgjithshëm i brendshëm dhe i jashtëm i qeverisë së RMV-së si dhe konsumi familjar i RMV-së. Nga variablat e pavarura statistikisht të rëndësishme për parashikimin e normës së rritjes ekonomike në RMV paraqitet vetëm një variabël e pavarur pasi që vlera e signifikancës është më e vogël se vlera  $p$  që është 0.05, edhe ate bilanci buxhetor i qeverisë me signifikancë 0.001. Sipas kësaj mund të konkludojm se vetëm bilanci buxhetor i qeverisë si variabël e pavarur shpjegon një varianc unike të normës së rritjes ekonomike në RMV.

Pasiqë në tabelën 4 mund të vërehet që në mënyrë të përbashkët variablat e pavarura janë statistikisht të rëndësishme për parashikimin e normës së rritjes ekonomike në RMV pasi që vlera e signifikancës është më e vogël se vlera  $p$  që është 0.05, edhe ate vetëm 0.006 mund të marrim një vendim të refuzojm të katër hipotezat zero dhe të pranojm hipotezat alternative, ose me sakt thënë se nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të refuzuar hipotezat alternative. Kjo nënkupton që nuk i refuzojm hipotezat alternative, edhe ate: H1/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis konsumit dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, H2/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis shpenzimeve qeveritare të ndërmarra nga qeveria dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, H3/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis borxhit të përgjithshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe

rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, H4/2: Egziston lidhje e rëndësishme midis tregtisë së jashtme dhe rritjes ekonomike të PBB-së së RMV-së gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Sipas këtyre hipotezave të ndara mund edhe të përfundojm në hipotezën e përgjithshme që pandemia COVID-19 dukshëm ka ndikuar në rritjen ekonomike reale të RMV.

Gjithashtu duke i analizuar korelacionet e studiuara mund të rezultojm se disa variabla të pavarura kanë korelacione pozitive me variablën e varur, ndërsa disa variabla të pavarura kanë korelacione negative me variablën e varur. Kjo nënkupton që me rritjen e konsumit gjithashtu do të kemi normë të rritjes ekonomike me 2.208%. Edhe borxhi i përgjithshëm i brendshëm është 1.823, gjë që është e pranueshme, sepse borxhi i përgjithshëm i brendshëm jep stimulim të rritjes ekonomike për 1.823%. Bilanci buxhetor i qeverisë si % e PBB-së është 1.262, nënkupton që për 1 përqind rritje të bilancit buxhetor, rritja ekonomike do të jetë 1.262%. Borxhi i përgjithshëm i jashtëm dhe bilanci tregtar rezultojn negative, edhe atë me rritjen prej 1 milion euro të borxhit të përgjithshëm të jashtëm ose bilancit tregtar, rritja ekonomike do të ulet për 1.327%, gjegjësisht për 0.001%. Masat ekonomike të qeverisë së RMV-së kanë qenë mjaft efektive në zbutjen dhe ringjalljen ekonomike të vendit.

Sa i përket rekomandimeve për studime të rradhës sugjerohet që të bëhen hulumtime të ngjashme në shtetet e rajonit dhe të shiqohet ndikimi i pandemisë COVID-19 në rritjen ekonomike të ekonomive të tyre si dhe të merren periudha më të gjata apo më të shkurta të serive kohore nga ajo që studiuesi në këtë hulumtim ka përdorur si dhe të mund të merren variabla tjera të pavarura që eventualisht mund të ndikojn në rritjen ekonomike të RMV-së dhe të mund të krahasohen rezultatet e fituara.

## **Referencat**

Almeida, V. (2021). The impact of Covid-19 on households' income in the EU. The journal of Economic Inequality. <https://doi.org/10.1007/s10888-021-09485-8>

Alili, Z. M. (2020). The impact of covid-19 on labour market in North Macedonia. 1st international scientific conference "Economic and Business Trends Shaping the Future". Faculty of Economics-Skopje, SS. Cyril and Methodius University in Skopje.

Arsovski, D., Nenovski, T., & Smiljkovski, I. (2009). *Javni finansii* [Public finance]. Ohrid: Center for Scientific Research at the Faculty for Tourism and Hospitality.

Bureau of Economic Analysis, (2021). Gross Domestic Product, Second Quarter 2021 (Advance Estimate) and Annual Update. Retrieved from: <https://www.bea.gov/data/gdp/gross-domestic-product>

Carlos, W.G., Cruz, C.S.D., Cao, B., Pasnick, S., Jamil, S. (2020). Novel Wuhan (2019-nCoV) Coronavirus. *Am J Respir Crit Care Med*, 201 (4), pp. 7-8, [doi:10.1164/rccm.2014P7](https://doi.org/10.1164/rccm.2014P7)

Chappell, B. (2020). "COVID-19: COVID-19 Is Now Officially a Pandemic, WHO Says," National Public Radio. Retrieved from: <https://www.npr.org/sections/goatsandsoda/2020/03/11/814474930/COVID-19-COVID-19-is-now-officially-a-pandemic-who-says>.

CDDEP, (2020). Modeling the spread and prevention of COVID-19, 2020. Retrieved from: <https://cddep.org/covid-19/>

Congressional Research Service, (2021). Global Economic Effects of COVID-19. CRS Report, R46270

Damme, et al., (2020). The COVID-19 pandemic: diverse contexts; different epidemics—how and why? *BMJ Global Health Journal*, 5(7), 003098

Department of Health and Social Care (2020). CMO confirms cases of Coronavirus in England, UK Government. Retrieved from: <https://www.gov.uk/government/news/cmo-confirms-cases-of-coronavirus-in-england>

De Vet, J.M. et al. (2021). Impacts of the Covid-19 pandemics on EU industries. Publication for the committee on Industry, Research and Energy, Policy Department for Economic, Scientific and Quality of Life Policies, European Parliament, Luxembourg.

Enti shtetëror i statistikës së RMV (2021). Употребени средства според намената на потрошувачката, по COICOP класификација и тип на домаќинство, по години. Retrieved from:

[https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_ZivotenStandard\\_AnketaZaPotrosuvackaDomakinstva/150\\_ZivStand\\_mk\\_UPOTREBENI\\_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_ZivotenStandard_AnketaZaPotrosuvackaDomakinstva/150_ZivStand_mk_UPOTREBENI_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)

Enti shtetëror i statistikës së RMV (2021b). Бруто-домашен производ според трошочниот метод, по тримесечја. Retrieved from:

[http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_BDP\\_BDPTrimesecni\\_BDPsporedESS2010/175\\_NacSmA\\_Mk\\_02RasKv\\_01\\_ml.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_BDP_BDPTrimesecni_BDPsporedESS2010/175_NacSmA_Mk_02RasKv_01_ml.px/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)

Eyawo, V. (2020). COVID-19: the rude awakening for the political elite in low- and middle-income countries. *BMJ Glob Health* 2020;5:e002807. [doi:10.1136/bmjgh-2020-002807](https://doi.org/10.1136/bmjgh-2020-002807)

Fernandez et al. (2021). Central Banks' Monetary Policy in the Face of the COVID-19 Economic Crisis: Monetary Stimulus and the Emergence of CBDCs. *Sustainability* 2021, 13, 4242. <https://doi.org/10.3390/su13084242>

Gigov, I.S. (2020). Impact of the Covid-19 Outbreak on Macedonian Trade Flows. *Journal of economic analysis*, 53 (2), pp. 156-167.

Institute of Public Health (2021). Press release 26.08.2021. Retrieved from: <http://iph.mk/wpcontent/uploads/2021/04/20.4.pdf>

International Monetary Fund. (2021). IMF Staff Concludes Virtual Visit to North Macedonia. Retrieved from:

<https://www.imf.org/en/News/Articles/2021/05/19/pr21135-IMF-Staff-Concludes-Virtual-Visit-to-North-Macedonia>

Jhingan, M. L. (2012). *Ekonomi Pembangunan dan Perencanaan*. Jakarta: Rajawali Press.

Kodri, B. & Jusufi, B.I. (2020). The impact of Covid 19 on North Macedonian Economy and Government Responses. UBT International Conference.

Lu, C.-w., Liu, X.-f., Jia & Z.-f. (2020). 2019-nCoV transmission through the ocular surface must not be ignored. *Lancet*, 395 (10224), p. e39, [doi:10.1016/s0140-6736\(20\)30313-5](https://doi.org/10.1016/s0140-6736(20)30313-5)

Mitev, M. A. & Drangovska, T. (2021). Economic and social impact of covid19 pandemic on global scale and in the case of the Republic of North Macedonia. *Journal of Economics-Special Issue*, vol.6, <https://doi.org/10.46763/JOE216>

Ministry of Finance of the Republic of North Macedonia, (2021a). *Basic macroeconomic indicators*. Retrieved from: <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Macroeconomic-indicators-1.xls>

Ministry of Finance of R. North Macedonia, (2021b). General government and guaranteed public debt. Retrieved from: <https://finance.gov.mk/publications-and-announcements/?lang=en>

Ministry of Finance of R. North Macedonia, (2021c). General-government-and-guaranteed-public-debt-September-2021. Retrieved from: <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2021/11/>

Mugenda, A. (2003). *Research Methods: Qualitative and Quantitative Approaches*. African Centre for Technology Studies, Nairobi.

Nanga, M. (2005). *Makro Ekonomi*, PT. Raja Grafindo Persada, Jakarta.

Nizetic, S. (2020). Impact of coronavirus (COVID-19) pandemic on air transport mobility, energy, and environment: A case study. [International Journal of Energy Research](https://doi.org/10.1016/j.ijer.2020.10953-10961), 44(13), pp. 10953-10961

OECD (2021). The COVID-19 crisis in North Macedonia, 31 January 2021. Retrieved from: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-North-Macedonia.pdf>

O'Hagan, C. (2020). 1.3 billion learners are still affected by school or university closures, as educational institutions start reopening around the world, says UNESCO. Retrieved from: <https://en.unesco.org/news/13-billion-learners-are-still-affected-school-university-closures-educational-institutions>

Organizata Botërore e Shëndetsisë (2020). WHO timeline – COVID-19. Retrieved from: <https://www.who.int/news-room/detail/08-04-2020-who-timeline---covid-19>

Petreski, M. (2021). Poverty during Covid-19 in North Macedonia: Analysis of the Distributional Impact of the Crisis and Government Response. Partnership for Economic Policy Working Paper No. 2021-01. <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3903373>

Qeveria e RMV, (2020). Masa, rekomandime dhe parandalim nga COVID-19. Retrieved from: <https://vlada.mk/node/26256?ln=sq>

Qeveria e RMV, (2021). Masat ekonomike të Qeverisë për parandalimin e krizës nga COVID-19. Retrieved from: <https://vlada.mk/node/22643?ln=sq>

Phillipson et al. (2020). The COVID-19 Pandemic and Its Implications for Rural Economies. Sustainability. 2020; 12(10):3973. <https://doi.org/10.3390/su12103973>

Pickard et al., (2021). Rishi Sunak delivers spend now, tax later Budget to kickstart UK economy. Financial Times. Retrieved from: <https://www.ft.com/content/da66ce9a-6dfc-4a3a-bde7-d4f4faed6c4a>

Qeveria e RMV, (2021). Masat ekonomike të qeverisë për parandalimin e krizës nga COVID-19. Retrieved from: <https://vlada.mk/node/22643?ln=sq>

Secon, H., Woodward, A., Mosher, D. (2020). U.S. Business Insider. A comprehensive timeline of the new Coronavirus pandemic, from China's first COVID-19 case to the present. Business Insider Malaysia. Retrieved from:

<https://www.businessinsider.my/coronavirus-pandemic-timeline-history-major-events-2020-3?r=US&IR=T>

Sebastiano, D. (2021). Covid-19: A Different Economic Crisis but the Same Paradigm of Democratic Deficit in the EU. *Politics and Governance*, 9(2), pp. 252-264

Sofiychuk, E. (2020). First two persons infected with Coronavirus identified in Russia. Tass. Retrieved from: <https://tass.com/society/1115101>

Stojkovski et al. (2020). The short-run impact of COVID-19 on the activity in the insurance industry in the Republic of North Macedonia. [arXiv:2011.10826](https://arxiv.org/abs/2011.10826)

Svrtinov et al. (2020). The impact of Covid-19 on Western Balkans economies. *Journal of Economics*, 5(2). <https://www.doi.org/10.46763/JOE205.2>

Svrtinov et al. (2021). [Banking Sector Performance During the COVID-19 Crisis in the Republic of North Macedonia](https://www.doi.org/10.46763/JOE216), *Journal of Economics*, 6(2). DOI <https://www.doi.org/10.46763/JOE216>

World Bank (2021). World Development Indicators. From: <https://data.worldbank.org/country/north-macedonia?view=chart>

Worldometer (2021). Reported Cases and Deaths by Country or Territory. Retrieved from: <https://www.worldometers.info/coronavirus/>

Xia, J., Tong, J., Liu, M., Shen, Z., Guo, D. (2020). Evaluation of Coronavirus in tears and conjunctival secretions of patients with SARS-CoV-2 infection. *J Med Virol*, [doi: 10.1002/jmv.25725](https://doi.org/10.1002/jmv.25725)

## **Anex A**

### **Masat ekonomike dhe sociale të Qeverisë së RMV për parandalimin e krizës nga COVID-19**

Masa 1 - Shteti kursen vende pune, 14,500 denarë në muaj për punonjës për prill dhe maj për vitin 2020, për kompanitë e prekura nga kriza ose 50% të kostos së kontributeve për secilin punonjës

Masa 2 - Ndihmë për atletët - 14,500 denarë për muajt prill dhe maj për vitin 2020, fonde të drejtpërdrejta për sportistët dhe punëtorët e sportit për të kursyer vendet e tyre të punës

Masa 3 - Ndihmë për artistët

Masa 4 - Kompensimi në para për qytetarët që humbën punën për shkak të krizës, në përputhje me kohëzgjatjen e shërbimit përmes Agjencisë së Punësimit

Masa 5 - Presidentët dhe anëtarët e bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të institucioneve publike nuk do të marrin kompensim për kohëzgjatjen e krizës

Masa 6 - Shteti kujdeset për njerëzit që ishin pjesë e ekonomisë joformale dhe humbën të ardhurat e tyre - siguron ndihmë financiare për familjet dhe shtesë energjie për përfituesit e mbrojtjes sociale

Masa 7 - Ligji për përmbarimin pezullohet deri në fund të qershorit

Masa 8 - Shtyrja e huave për bankat

Masa 9 - Reduktimi i këstit dhe riprogramimi i huave për kompanitë financiare dhe kompanitë e lizingut

Masa 10 - Shtyjeni pagesën e qirasë për përdoruesit e banesave sociale

Masa 11 - Kredi shtesë pa interes për kompanitë me 8 milionë euro të reja

Masa 12 - 50 milionë euro kredi të lira nga Banka për Zhvillim e Republikës së Maqedonisë Veriore të vendosura përmes bankave komerciale për të mbrojtur likuiditetin e kompanive

Masa 13 - Ndalohet hapja e një procedure falimentimi

Masa 14 - Përdorimi i detyrueshëm i pjesës së parë të pushimit vjetor

Masa 15 - Krijimi i një fondi solidariteti COVID -19

Masa 16 - Ulja e honorareve



Masa 17 - Transporti i pandërprerë i mallrave, trafiku rrugor dhe lehtësimi i punës së kompanive nga sektori i ndërtimit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

Masa 18 - Mbështetje për ruajtjen e aktivitetit ekonomik dhe eksporteve

Masa 19 - Mbështetje financiare për muajt Prill dhe Maj 2020 në vlerë prej 14,500 denarë në muaj për individët që kryejnë veprimtari të pavarur

Masa 20 - Subvencionimi i 50% të kontributeve për punonjësit në kompani nga sektorët e turizmit, transportit dhe hotelierisë dhe kompani të tjera të prekura nga koronavirusi

Masa 21 - Ngrirja e çmimeve të limonit, portokallit, mandarinës, grejpfrutit dhe klementinës

Masa 22 - Ndalimi i eksportit të grurit dhe miellit

Masa 23 - Ngrirja, zgjatja ose shtyrja e huave për qytetarët dhe kompanitë e prekura nga kriza e koronës

Masa 24 - Përrjashtimi nga pagesa e shumës së paradhënieve të tatimit mbi të ardhurat personale dhe shumës së paradhënieve të tatimit mbi fitimin për muajt mars, prill dhe maj 2020

Masa 25 - Mbështetje për pagesën e pagave, e cila vazhdon të jetë e vlefshme për tremujorin e fundit të vitit, pra për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor

Masa 26 - Kartat e pagesave për qytetarët për konsum më të lartë dhe për zhvillimin e aktiviteteve të brendshme ekonomike

Masa 27 - Rritja e periudhës së hirit për kreditë pa interes nga KOVID-1

Masa 28 - 100 milionë euro kredi të reja të favorshme nga Banka për Zhvillim e Republikës së Maqedonisë Veriore

Masa 29 - Mbështetje pagash për guidat turistike

Masa 30 - Rimbursimi i taksës turistike për vitin 2019 për të mbështetur sektorin e turizmit, si një nga më të prekurit nga kriza

Masa 31 - Grantet për agjencitë e udhëtimit nga 3,000 në 7,000 euro

Masa 32 - Reduktimi dhe / ose heqja e detyrave parafiskale

Masa 33 - Grantet për restorantet e restoranteve për dasma

Masa 34 - Zgjatja e licencave për funksionimin e disko, klubeve të natës dhe kompanive nga komuniteti i transportit

Masa 35 - Grantet për terrenet e lojërave për fëmijë

Masa 36 - Mbështetje për artizanatët

Masa 37 - Garancia e kredisë shtetërore

Masa 38 - Garancia doganore shtetërore

Masa 39 - Shtyrje shtesë e shlyerjes së huasë për kompanitë, deri në fund të vitit

Masa 40 - Ulja e interesit ndëshkues për detyrat publike nga gjysma nga 0.03% në 0.015% deri në fund të vitit

Masa 41 – Shtyrje e pagesës paraprake të tatimit mbi fitimin

Masa 42 - Përjashtim nga TVSH për donacionet publike, për 12 muaj të tjerë

Masa 43 - Ulja e normës së TVSH -së për shërbimet e restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit dhe pijeve, me anë të së cilës këto shërbime do të tatonen me një normë të re preferenciale të TVSH -së prej 10% në vend të normës aktuale të rregullt prej 18%

Masa 44 - Pagesa e shtyrë e TVSH -së

Masa 45 - Fshirja e kërkesës për grumbullimin e pikëve nga Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (IÇK) për rinovimin e licencës për kontabilistët

Masa 46 – Rritja e periudhës për të mbuluar humbjet në kurriz të fitimeve të ardhshme

Masa 47 - Rritja e pragut me të cilin njësitë ekonomike do të ishin pjesë e regjimit jo-tatimor me tatimin mbi fitimin dhe rritja e pragut me të cilin njësitë ekonomike do të hynin në regjimin e të ardhurave totale

Masa 48 - Njohja e kostos së sigurimit shëndetësor privat si shpenzim i njohur

Masa 49 - Njohja e kostove të testit të COVID - 19, e njohur gjithashtu si kosto

Masa 50 - Ulja e detyrimeve të importit për lëndët e para

Masa 51 - Mbështetje për zhvillimin e kapitalit njerëzor

Masa 52 - Mbështetje për blerjen e rrushit nga korrja 2020

Masa 53 - Përjashtim në masën 2/3 e shumës së përcaktuar ligjërisht për organizatorët e lojërave të fatit

Masa 54 - Ndryshimi i llogaritjes së bazës për financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Masa 55 - Fundjavë pa TVSH

Masa 56 - Mbështetje financiare për artistët e estradës

Masa 57 - Grantet për Shoqatën e Shoqatave të Vallëzimit

Masa 58 - Subvencionet për institucionet private për fëmijët -kopshte

Masa 59 - Mbështetje financiare për studiot e projektimit

Masa 60 - Grante për qendrat arsimore për fëmijët

Masa 61 - Grante për qendrat e gjuhëve të huaja

Masa 62 - Ndihmë financiare për klubet e natës

Masa 63 - Subvencionet për organizatat rinore

Masa 64 - Ndihmë financiare për Transport Hekurudhor

Masa 65 - Asistencë financiare për 58 transportues të licencuar

Masa 66 - Ndihmë financiare për pagesën e pagave për GTC AD Shkup

Masa 67 - Mbështetje financiare për AD Vodostopanstvo

Masa 68 - Ndihmë financiare për artistë të pavarur, punonjës të filmave, artistë dhe punonjës të kulturës

Masa 69 - Ndihmë financiare për transportuesit - MAKEKSPRESS TRANSPORT DOO Shkup

Masa 70 - Ndihmë financiare për transportuesit - DPPU Sloboda prevoz Shkup

Masa 71 - Mbështetje financiare e pagave për punonjësit

Masa 72 - Kredi me norma interesi 0% për sektorët më të prekur (turizëm, zanat, hotelieri, transport, industri të organizimit të ngjarjeve, institucione private të kujdesit shëndetësor, etj.)  
Përmes Bankës së Zhvillimit

Masa 73 - Mbështetje financiare për transmetuesit

Masa 74 - Përrjashtim nga tarifa MUKS për transmetuesit në 2021

Masa 75 - Mbështetje financiare për zejtarët e regjistruar

Masa 76 - Përrjashtim nga pagesa e paradhënëve të tatimit mbi të ardhurat personale për të vetëpunësuarit deri më 30.6.2021

Masa 77 - Mbështetje financiare për transportuesit ndërkombëtarë për pagesën e pagave për Mars dhe Prill për vitin 2021

Masa 78 - Nga 3,000 në 10,000 euro për rreth 200 kompani të regjistruara që transportojnë pasagjerë të cilët kanë një rënie të të ardhurave prej më shumë se 50%

Masa 79 - Skema e garancisë së kredisë në periudhën Prill - Tetor 2021 përmes Bankës së Zhvillimit

Masa 80 - Zgjatja e periudhës së faljes për pagesën e detyrimeve për huamarrësit e linjës së kredisë "Kovid 2" me Bankën e Zhvillimit

Masa 81 - Mbështetja e ngjarjeve me interes publik për kompanitë që organizojnë ngjarje, shtëpi prodhimi, televizione dhe radio kombëtare dhe lokale

Masa 82 - Mbështetje financiare për hotelet që operojnë jashtë qendrave turistike, të cilat nuk kanë përdorur kuponë

Masa 83 - Fondi për mbështetjen e kompanive eksportuese përmes Bankës për Zhvillim

Masa 84 - Mbështetje për klubet sportive 33% e shumës që ata marrin sipas sistemit të kuponëve për t'u paguar nga Buxheti në fillim të vitit

Masa 85 - Heqja e tarifave doganore për 71 produkte dhe lëndë të para deri në fund të vitit 2021

Masa 86 - Heqja dhe ulja e tarifave doganore për 31 lëndë të para dhe mish për kompanitë eksportuese deri në fund të vitit 2021

Masa 87 - Mbështetje për kompanitë eksportuese Rishikimi i Tarifës Doganore dhe harmonizimi me rregullat e tregut të BE -së dhe tregjet e anëtarëve të OBT -së

Masa 88 - Kushtet lehtësuese për 245 kompani që kanë kontrata aktive dhe të reja që do të investojnë sipas Ligjit për Mbështetjen Financiare të Investimeve

Masa 89 - Ndihmë e bashkëfinancuar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe institucionet shëndetësore private për zhvillimin teknologjik për rritjen e përshpejtuar ekonomike në periudhën KOVID-19 përmes FITR

Masa 90 - Përdorimi i mjeteve nga bllok grantet e papërdorura për komunat për investime kapitale

Masa 91 - Mbështetje financiare për prodhuesit e duhanit

Masa 92 - Fshirja e interesit për borxhet e qytetarëve ndaj institucioneve dhe ndërmarrjeve publike

Masa 93 - Mbështetje financiare për 38 punonjës shëndetësorë të lënë jashtë paketës së tretë të masave

Masa 94 - Zgjatja e përkohshme e koncesioneve dhe shtyrja e mbledhjes së tarifës për licencat dhe lejet për kryerjen e aktiviteteve

Masa 95 - Përrjashtimi nga detyrimet kontraktuale (pagesa e gjobave) për kontratat e nënshkruara me NJVL -të e kompanive të prekura nga kriza

Masa 96 - Mbështetje financiare për përrpunuesit dhe eksportuesit e rrushit

Masa 97 - Mbështetje financiare për sipërrmarrësit romë duke krijuar një "Fond Meching për Sipërrmarrje për Romët"

Masa 98 - Rritja e pragut të përrjashtimit nga tatimi me tatimin mbi fitimin në pushimin vjetor nga 40% në 80%

Masa 99 - Transformimi dixhital i bizneseve për rigjallërim më të shpejtë post-Covid për ndërrmarrjet mikro dhe të vogla

Masa 100 - Mbështetje financiare për 6,000 furnizues ushqimesh me rreth 17,000 punonjës

Masa 101 - Mbështetje financiare për vendpushimet private të fëmijëve, klubet e natës, terrenet e lojërave, restorantet e dasmave, industrinë e ngjarjeve, qendrat e fitnesit, fotografët dhe studiot e fotografive

Masa 102 - Mbështetje financiare për agjencitë e kategorizuara të udhëtimit

Masa 103 - Mbështetje financiare për të gjithë muzikantët dhe guidat turistike

Masa 104 - Mbështetje financiare për likuiditetin e kompanive

Masa 105 - Linja krediti pa interes për mediat që transmetojnë programe radio dhe televizive

Masa 106 - Teste pa pagesë PCR për turistët e huaj që qëndrojnë në vend